



**UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË**

UNIVERSITETI KATOLIK “ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË”

STATUTI

Rektori


Prof. Bruno Giardina



Tiranë, 2018



KREU I PARË – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- Neni 1 – Krijimi dhe statusi juridik
- Neni 2 – Misioni
- Neni 3 – Veprimtaria
- Neni 4 – Parime themelore
- Neni 5 – Autonomia akademike
- Neni 6 – Financimi i veprimtarisë
- Neni 7 – Stema dhe vula
- Neni 8 – Selia kryesore dhe selitë dytësore
- Neni 9 – Mënyra e realizimit të misionit dhe të programeve dhe zhvillimi i kërkimit shkencor dhe i veprimtarive të tjera institucionale

KREU I DYTË – ORGANIZIMI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV

- Neni 10 – Organizimi dhe funksionimi
- Neni 11 – Organet drejtuese. Dispozita të zakonshme

SEKSIONI I – ORGANIZIMI AKADEMIK

- Neni 12 – Senati Akademik: përbërja
- Neni 13 – Funksionet e Senatit Akademik
- Neni 14 – Dispozita të veçanta për funksionimin e Senatit Akademik
- Neni 15 – Rektori
- Neni 16 – Zëvendësrektori
- Neni 17 – Këshilli i Rektoratit
- Neni 18 – Sekretari i përgjithshëm
- Neni 19 – Këshilli i etikës
- Neni 20 – Asambleja e Personelit Akademik
- Neni 21 – Komisionet e përhershme
- Neni 22 – Dispozita të veçanta për Njësinë e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë dhe për Komisionin e disiplinës
- Neni 23 – Fakultetet
- Neni 24 – Dekani (ose Drejtuesi i Njësisë Kryesore)
- Neni 25 – Zëvendësdekani
- Neni 26 – Dekanati (ose Këshilli i Fakultetit)
- Neni 27 – Njësia bazë
- Neni 28 – Departamenti
- Neni 29 – Qendra kërkimore – shkencore
- Neni 30 – Drejtuesi i Njësisë bazë



SEKSIONI II – ORGANIZIMI ADMINISTRATIV

- Neni 31 – Bordi i Administrimit: përbërja
- Neni 32 – Funksionet e Bordit të Administrimit
- Neni 33 – Dispozita të veçanta për disa aspekte ekonomiko-financiare të Bordit të Administrimit
- Neni 34 – Administratori i Universitetit
- Neni 35 – Administratori i Fakultetit (ose i Njësisë kryesore)

KREU I TRETË – PERSONELI I INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË

- Neni 36 – Personeli i Institucionit të arsimit të lartë



SEKSIONI I – PERSONELI AKADEMIK

- Neni 37 – Veprimtaritë dhe *statusi* i Personelit Akademik
- Neni 38 – Kategoritë e Personelit Akademik
- Neni 39 – Viti akademik sabbatik
- Neni 40 – Shpërblimet e Personelit akademik

SEKSIONI II – PERSONELI TEKNIKO-ADMINISTRATIV

- Neni 41 – Personeli tekniko-administrativ

SEKSIONI III – STUDENTËT

- Neni 42 – Statusi juridik i studentëve
- Neni 43 – Mbështetje për studimet
- Neni 44 – Këshillat e studentëve
- Neni 45 – Bashkëpunim me botën e punës
- Neni 46 – Garantuesi i studentëve

KREU I KATËRT – ORGANIZIMI I STUDIMEVE

- Neni 47 – Programet e studimit
- Neni 48 – Pranimet
- Neni 49 – Transferimet
- Neni 50 – Provimet vjetore dhe të diplomës
- Neni 51 – Titujt e studimit
- Neni 52 – Diploma, Suplementi i Diplomës, Çertifikata ekuivalente
- Neni 53 – Dokumentacioni i Procesit Mesimor

KREU I PESTË – KËRKIMI SHKENCOR

- Neni 54 – Veprimtaritë e kërkimit shkencor
- Neni 55 – Dispozita të veçanta për profilet financiare të kërkimit shkencor
- Neni 56 – Botimet

KREU I GJASHTË – DISPOZITA PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

- Neni 57 – Dispozita mbi buxhetin, kontabilitetin, shpërndarjen e aseteve dhe kontrollin e brendshëm financiar (auditimin)
- Neni 58 – Afati për shprehjen e mendimeve të brendshme
- Neni 59 – Rregullore
- Neni 60 – Përfundimi i funksioneve dhe krijimi i organeve të reja
- Neni 61 – Gjuha dhe interpretimi i Statutit





KREU I PARË DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 - Krijimi dhe statusi juridik

1. Shkolla e Lartë Universitare jo publike *Zoja e Këshillit të Mirë*, e njohur si e tillë me Vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë n. 567 datë 27.08.2004, është krijuar nga Fondacioni *Zoja e Këshillit të Mirë* (i referuar më poshtë si Fondacioni ZKM), i njohur si person juridik me vendimin n. 8 datë 24.11.1993 të Gjykatës së Tiranës.

2. Në bazë të zhvillimit të Institucionit, arritjes së standardeve të cilësisë dhe pajtueshmërisë së veprimtarive të saj me vlerat dhe parimet katolike, me vendimin e mëvonshëm të Këshillit të Ministrave, n. 670 datë 28.09.2011, iu njoh *statusi* dhe emërtimi **Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”** (i referuar më poshtë si UniKZKM).

3. UniKZKM-ja është një institucion i lartë jo publik dhe jo fitimprurës, që zhvillon veprimtarinë e arsimit universitar dhe të kërkimit shkencor dhe që ndjek çdo objektiv tjetër në autonomi të plotë, sipas synimeve karizmatike të At Luigji Maria Montit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 2 - Misioni

1. UniKZKM-ja, në harmoni me frymën e Themeluesve të tij dhe në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor të Vendit, ka misionin:

- t'u garantojë studentëve të tij nivelet e duhura të arsimit të lartë dhe të formojë specialistë dhe profesionistë të rinj sipas *standardeve* evropiane dhe me vlerat më të mira morale, me qëllim që të mbështesë zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor të shoqërisë shqiptare dhe përparimin e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor në nivel kombëtar dhe rajonal;
- të zhvillojë dhe të nxisë kërkimin shkencor bazë dhe atë të zbatuar;
- të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të Vendit;
- të nxisë bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor;

2. UniKZKM-ja e kryen misionin e vet të arsimit të lartë nëpërmjet qasjes edukative të bazuar në parimet dhe vlerat katolike dhe në veçanti në respektimin e të drejtave themelore të njeriut, të barazisë ndërmjet anëtarëve të shoqërisë, grupeve të ndryshme etnike, feve dhe kombësive, sipas një konceptimi që e vë shkencën në shërbim të njeriut dhe të bashkëjetesës civile.

Neni 3 – Veprimtaria

1. Veprimtaritë kryesore të Universitetit janë:

- zhvillimi dhe menaxhimi i veprimtarive mësimore në tri ciklet e studimeve universitare, duke pasur parasysh në veçanti aktivizimin e *programeve të përbashkëta* studimore për dhënien e *diplomave të përbashkëta* ose të *dyfishta*, përmes marrëveshjeve me Universitete të Vendeve të tjera. Për këtë qëllim, krijohen *kurrikula* dhe programe të përshtatshme për realizimin e këtij objekti. Për menaxhimin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore - shkencore të programeve të përbashkëta të studimit, UniKZKM-ja mund të bjerë dakord me *partnerët*, sipas procedurave të treguara në këtë statut, për krijimin e organeve specifike të përbashkëta që nuk janë parashikuar në këtë Statut ose në rregulloret e brendshme;
- zhvillimi i veprimtarive Kërkimore Shkencore;



- organizimi dhe zhvillimi i shërbimeve për komunitetin, veçanërisht në sektorin e shëndetësisë.

2. Veprimtari të tjera institucionale të UniKZKM-së janë gjithashtu:

- a) realizimi i projekteve kërkimore - shkencore për çështje që lidhen me interesat shkencore-kulturore të Universitetit, në perspektivat e zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe kulturor të Shqipërisë dhe të Ballkanit, si dhe me linjat dhe me objektivat e planifikimit të Bashkimit Evropian;
- b) shërbime për orientimin, trajnimin, përditësimin në fushën kulturore, shkencore dhe teknike, edhe në bashkëpunim me organizma të tjera publike dhe private, shqiptare apo të huaja, në përputhje me marrëveshje të posaçme të nënshkruara me ato;
- c) kryerja e detyrave të tilla si:
 - c. 1 orientim i të rinjve për pranimin në programet universitare dhe informacion mbi planet e studimit;
 - c. 2 iniciativa të tjera orientuese dhe trajnuese;
 - c. 3 trajnime dhe veprimtari studimore për administratat publike dhe shoqëri tregëtare;
 - c. 4 organizimi dhe zhvillimi i programeve të kualifikimit të vazhduar;
 - c. 5 pjesëmarrje në nisma të ndërmarra nga subjekte të tjera me interes të veçantë shkencor, arsimor dhe, më në përgjithësi, kulturor;
 - c. 6 veprimtari sociale, ku përfshihen gjithashtu ato për shëndetin dhe mirëqënien, që synojnë kujdesin për personin dhe promovimin e dinjitetit njerëzor dhe të familjes;
 - c. 7 veprimtari për pritjen e studentëve;
 - c. 8 përditësim, rikualifikim profesional dhe trajnim i përhershëm i Personelit të tij tekniko-administrativ, por edhe i subjekteve të jashtme;
 - c. 9 çdo veprimtari dhe iniciativë tjetër paraprake, praktike dhe e mëtejshme, ose që sidoqoftë është e dobishme, për të arritur misionin e tij;

3. Gjuhët e veprimtarive të mësimdhënies dhe të trajnimit janë shqipja, italishtja dhe anglishtja. Programet e studimit mund të zhvilloheshin edhe në gjuhë të tjera (Frëngjisht, Gjermanisht, Spanjisht) nëse shihet e nevojshme.

Neni 4 – Parime themelore

1. UniKZKM-ja i përmbush detyrat e veta nëpërmjet një arsimit të lartë dhe një qasjeje edukative të bazuar në *standardet* më të përditësuara dhe më të larta të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor dhe në veçanti në respektimin e të drejtave themelore të njeriut, të barazisë ndërmjet anëtarëve të shoqërisë, grupeve të ndryshme etnike, feve dhe kombësive, sipas një konceptimi që e vë shkencën në shërbim të njeriut dhe të bashkëjetesës paqësore civile.

2. Liria e mësimdhënies dhe e kërkimit shkencor, njihet dhe vlerësohet në bazë të përmbajtjes dhe të metodave të secilës lëndë, për mbrojtjen e dinjitetit njerëzor dhe të autonomisë vetjake të secilit anëtar të komunitetit universitar, si edhe në mbështetje të nevojave të së vërtetës dhe të interesit të përgjithshëm.

3. Personeli mësimor dhe ai kërkimor - shkencor, personeli administrativ-teknik dhe studentët duhet të respektojnë parimet dhe vlerat themelore të Universitetit dhe, sipas funksioneve dhe



përgjegjësi përkatesë, duhet të kontribuojnë për funksionimin korrekt të tyre, mbi bazën e parimeve të sjelljes të renditura si më poshtë:

- a) përmbushje e saktë e detyrimeve institucionale dhe bashkëpunim efektiv në organizimin e veprimtarisë mësimore edhe për shpërndarjen e ekuilibruar të ngarkesës mësimore;
- b) bashkëpunim në veprimtarinë shkencore, duke treguar kujdes të veçantë për thellimin e njohurive, qarkullimin e informacionit, krijimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve me universitete të tjera, me institucione të kulturës së lartë, me qendra të kërkimit shkencor kombëtar, të huaja ose ndërkombëtare, me organizma dhe organe, publike ose private, që veprojnë në fushën e arsimit;
- c) bashkëpunim i vazhdueshëm për përdorimin me sa më shumë rendiment të burimeve dhe të shërbimeve të ofruara nga UniKZKM-ja;
- d) pjesëmarrje aktive në promovimin dhe realizimin e iniciativave me interes dhe përfitim të përbashkët për institucionin universitar dhe në ato që kanë për qëllim përhapjen e vlerave të përkrahjes, të përgjegjësisë dhe të solidaritetit.

Neni 5 - Autonomia akademike

1. UniKZKM-ja gëzon liri të plotë në zhvillimin e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, në përputhje me Ligjin nr. 80 të vitit 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe rregulloret pasuese për zbatimin e tij. Autonomia akademike, në përputhje me zhvillimin historik të institucionit universitar dhe me vlerat karakteristike të jetës aktuale në Evropë, shprehet në respektimin e shumëllojshmërisë së opinionëve, të ideve dhe të metodave, në garantimin e zhvillimit të lirë, kritik dhe krijues të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe të veprimtarive të tjera akademike, në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe të anëtarëve të ndryshëm të shoqërisë, me synimin për të arritur të mirën e përbashkët.

2. UniKZKM-ja, gëzon autonominë e parashikuar nga ligji për kryerjen e misionit dhe të veprimtarive të tij, si dhe në fusha të tjera që nxisin zhvillimin e tij institucional. Gjithashtu ai mund:

- a) të organizojë strukturat e brendshme dhe veprimtaritë e ndryshme në bazë të këtij Statuti dhe të rregulloreve të tij, të miratuara në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- b) të hartojë dhe të zhvillojë programe studimi dhe projekte kërkimore - shkencore të veta;
- c) të përgatisë rregullat e pranimit të studentëve në programet e studimit për të gjitha nivelet dhe në veprimtari të tjera të promovuara nga ai vetë ose me subjekte të tjera;
- d) të nënshkruajë dhe të realizojë marrëveshje me institucione dhe ente të tjera publike e private, edhe përsa i përket fushës së trajnimit dhe të realizimit të projekteve kërkimore - shkencore;
- e) të krijojë marrëdhënie me Universitete të tjera, me qendra kërkimore - shkencore dhe me subjekte të tjera publike dhe private, kombëtare dhe të huaja, për realizimin e qëllimeve të misionit të institucionit dhe për përmbushjen e objektivave të tij;
- f) të aderojë në organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, në mënyrë të përhershme dhe të përkohshme dhe të marrë pjesë gjithashtu në veprimtaritë e tyre në fushën e arsimit universitar dhe të kërkimit shkencor;



- g) të menaxhojë ose të mbikëqyrë veprimtari në lidhje me botimet shkencore apo informuese, në përputhje me nevojat e proceseve të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor;
- h) të përzgjedhë dhe të emëroje Personelin mësimor dhe kërkimor - shkencor;
- i) të menaxhojë hapësirat dhe të gjitha mjetet e vëna në dispozicion nga Fondacioni ZKMose që janë të destinuara për veprimtari universitare nga subjekte të tjera, në përputhje me dispozitat e veta ligjore dhe rregullatore.

Neni 6 – Financimi i Veprimitarisë

1. UniKZKM-ja, në thelb, vepron sipas kritereve të vetë - financimit. Të ardhurat në dispozicion përfaqësohen nga:

- a) kontribute të Fondacioni ZKM;
- b) tarifa shkollimi dhe kontribute të tjera financiare të paguara nga studentët dhe nga të regjistruarit e tjerë në programet përkatëse;
- c) të ardhura nga veprimtaritë e tij;
- d) bashkëpunime me organizma publike dhe private;
- e) fonde për realizimin e projekteve kërkimore - shkencore të zhvilluara nga vetë UniKZKM-ja, ose në partneritet me palët e treta, ose te të cilët gjithsesi marrin pjesë personeli akademik ose kërkimor - shkencor i tij;
- f) financime të marra nga organizma publike dhe private të një natyre lokale, rajonale, kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe nga burime të ligjshme dhe donacione.

2. Modalitetet e pranimit dhe të përdorimit të të gjitha të ardhurave, në çdo rast, përcaktohen, ose autorizohen, nga Bordi i Administrimit (i referuar më poshtë si B.A.).

3. UniKZKM-ja organizon një sistem kontrolli të brendshëm mbi rregullsinë e përdorimit të të ardhurave nga veprimtaritë e tij, të financimeve të jashtme dhe të çdo të ardhure tjetër.

Neni 7 - Stema dhe vula

1. Stema e UniKZKM-së është në formë ovale, me ngjyrë blu dhe të bardhë, ku përshkruhet Zoja e Shkodrës me fëmijën në mes. Në pjesën e sipërme gjendet mbishkrimi latin “*UNIVERSITAS CATHOLICA MATER BONI CONSILII*”; në pjesën e poshtme, e ndarë nga pjesa e sipërme nga dy yje të verdhë, shkruhet motoja e Universitetit “*RENOVABITUR SICUT AQUILAE*”.

2. Vula e UniKZKM-së përbëhet nga një stemë në formë rrethi.

3. Stema dhe vula duhet të paraqiten në të gjithë dokumentacionin zyrtar të UniKZKM-së (Shtojca1)

Neni 8 – Selia kryesore dhe degët

1. UniKZKM-ja e zhvillon veprimtarinë e vetnë:

- a) selinë kryesore në Tiranë, në Rr. Dritan Hoxha, Kompleksi Spitalor Universitar “Zoja e Këshillit të Mirë”, në pronësinë dhe në selinë e Fondacionit ZKM;
- b) degëne Elbasanit, në Rr. Qemal Stafa, n. 7 (Lagjja “Beqir Dardha”);
- c) degën e Romës, në Rr. Vicolo del Conte, nr.2;
- d) seli të tjera të mundshme shqiptare ose të huaja.



Neni 9 – Mënyra për realizimin e misionit dhe të programeve dhe zhvillimi i kërkimit shkencor dhe i veprimtarive të tjera institucionale

1. UniKZKM-ja, në përputhje me rregullat e sistemit ligjor shqiptar, çon përpara misionin e vet dhe kryen çdo veprimtari institucionale brenda sistemit universitar kombëtar dhe rajonal, duke bashkëpunuar me Institucionet e tjera të arsimit të lartë dhe duke menaxhuar, tërësisht në mënyrë të pavarur, çdo marrëdhënie që lidhet me këtë bashkëpunim.

2. Për realizimin e programeve didaktike, trajnuese dhe kërkimore - shkencore, UniKZKM-ja shfrytëzon strukturat e Fondacioni ZKM dhe ato të vëna në dispozicion nga institucione të tjera me të cilat ka marrëveshje.

3. Në fusha të ndryshme të ekspertizës së Personelit të tij akademik, në përputhje me misionin e tij, me parimet dhe vlerat e tij katolike dhe vokacionin e tij ndërkombëtar, ai përgatit dhe zbaton, gjithashtu në partneritet me palët e treta, programe shkencore dhe projekte kërkimore - shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Projektet mund të përfshijnë, përveç çështjeve të lidhura ngushtë me interesat shkencore të Universitetit, edhe zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të Shqipërisë, të rajonit të Ballkanit dhe të linjave të zhvillimit të Bashkimit Evropian.

4. Me pëlqimin e Fondacioni ZKM dhe në përputhje me legjislacionin aktual, mund të themelojë struktura shëndetësore, degë të tjera, në Shqipëri ose në Vende të huaja, institute të tjera ose Qendra kërkimore - shkencore dhe trajnuese të brendshme, në bashkëpunim edhe me Universitete dhe organizma të tjerë publikë dhe privatë, ose të bashkohet me struktura, institute dhe qendra të jashtme, ashtu si të marrë pjesë në veprimtaritë e tyre.

KREU I DYTË ORGANIZIMI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV

Neni 10 – Organizimi dhe funksionimi

1. UniKZKM-ja organizon strukturat dhe i kryen veprimtaritë e veta në përputhje me Ligjin, me rregulloret e tjera për arsimin universitar, me këtë Statut, me Rregulloret zbatuese, me Kodin e Etikës, me rregulloret e brendshme dhe me Marrëveshjet e nënshkruara me palë të treta (Shtojca 2).

2. Organizimi dhe funksionimi i tij kërkon, nga njëra anë, të sigurojë mundësi të barabarta, bazuar në kriterin e meritokracisë, për të gjithë ata që dëshirojnë të angazhohen në mësimdhënie, në kërkime shkencore dhe në studime, dhe nga ana tjetër, të kontribuojë në zhvillimin e një sistemi universitar kombëtar dhe evropian të bazuar në autonomi dhe konkurrencë të lirë midis institucioneve të arsimit të lartë, Personelit Akademik dhe atij studentor.

3. Të gjitha organet e tij veprojnë në bazë të mekanizmave operative dhe kriterëve ekonomike-financiare të qëndrueshme dhe transparente në mënyrë që të sigurohet cilësia në shërbimet e ofruara, në përputhje me *standardet* universitare evropiane.

4. Për këto qëllime, çdo vit akademik, UniKZKM-ja paraqet raportin vjetor për veprimtaritë e zhvilluara, dokumentacionin mbi gjendjen e pronësisë dhe të asaj ekonomike-financiare, planifikimin e burimeve për punësime të reja, pagesat e regjistrimit dhe të pjesëmarrjes në programet e ndryshme të studimit për vitin pasardhës, të dhënat analitike që kanë të bëjnë me të regjistruarit që kanë përfunduar studimet e tyre, si dhe çdo element tjetër që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.



Neni 11 – Organet dhe autoritetet drejtuese.

1. Organet drejtuese të UniKZKM-së ndahen, në organe akademike, në organe administrative dhe në organe kolegjiale .

2. Organidrejtues më i lartë akademik i UniKZKM-së është Senati Akademik (S.A.).

3. Organe të tjera drejtuese akademike janë Asambleja e Personelit akademik dhe Komisionet e përhershme.

4. Autoritetet akademike janë: Rektori, Drejtuesii Njesisë kryesore (Dekanii Fakultetit) dhe Drejtuesii Njesisë bazë (Drejtuesi i Departamentit ose i Qendrës kërkimore-shkencore). Me propozim të Rektorit, mund të krijohen edhe autoritete dhe organe të tjera institucionale, të cilave u caktohen detyra specifike.

5. Organi drejtuesmë i lartë administrativ i UniKZKM-së është Bordi i Administrimit (B.A.).

6. Autoritetet administrative janë: Administratori i Universitetit dhe Administratorët e Njësive kryesore (ose të Fakulteteve).

7. Organe të tjera kolegjiale janë: Këshilli i Rektoratit, Dekanati, Këshilli i Etikës.

8. Organet kolegjiale të UniKZKM-së thirren nga Kryetari i tyre, i cili gjithashtu përcakton rendin e ditës për mbledhjen, koordinon punën dhe siguron informacionet e nevojshme për vendimet që do të merren për secilën pikë të rendit të ditës. Kryetari është i detyruar ta thërrasë organin pas kërkesës me shkrim të së paku një të tretës së anëtarëve të tij.

9. Mbledhjet e organeve drejtuese dhe te atyre kolegjiale konsiderohen të vlefshme me praninë e shumicës së anëtarëve në detyrë. Përveç rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Statut, vendimet merren me shumicën e votave të personave të pranishëm. Në rast barazie votash, mbizotëron vota e Kryetarit.

10. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, mandati i anëtarëve të organeve kolegjiale, i autoriteteve akademike dhe administrative dhe i autoriteteve të tjera drejtuese, zgjat katër vjet dhe është i rinovueshëm. Pavarësisht nga kjo, mandati i autoriteteve ose i anëtarëve të organeve drejtuese dhe te atyre kolegjiale mbaron para kohe:

- a) në rastin e dorëheqjes vullnetare ose të ndonjë pengese të përhershme për ushtrimin e detyrës;
- b) si rezultat i ndërprerjes ose i ndryshimit të marrëdhënies akademike të studimit ose të punës me UniKZKM-në, gjë që i bën të pavlefshme kriteret që kërkohen për ushtrimin e kësaj detyre;
- c) pas mungesës së tretë të pajustificuar në një mbledhje të thirrur në mënyrë të rregullt;
- d) për shkelje të rëndë ose të përsëritur të ligjeve të sistemit universitar, të këtij Statuti, të Rregulloreve, të Kodit të etikës dhe të dispozitave të tjera të UniKZKM-së;
- e) për shkak të arrestimit në flagrancë për vepra penale për të cilat Ligji parashikon një dënim me burgim jo më pak se dy vjet, si dhe për dënimet penale të formës së prerë që parashikojnë një burgim total prej jo më pak se gjashtë muaj;

11. Në rast të ndërprerjes së parakohshme të detyrës, mandati i subjektit të caktuar për të ushtruar këtë detyrë, do të zgjasë po aq sa periudha e mbetur deri në skadimin e parashikuar për mandatin e subjektit të zëvendësuar, përveç rastit kur përcaktohet ndryshe nga Enti përgjegjës.



SEKSIONI I
ORGANIZIMI AKADEMIK

Neni 12 - Senati Akademik: përbërja

1. Senati Akademik është organi drejtues më i lartë akademik i UniKZKM-së.

2. Senati përbëhet nga:

- a) Rektori, me funksionin e Kryetarit;
- b) Zëvendësrektori;
- c) Drejtuesit e Njësive kryesore (Dekanët e Fakulteteve);
- d) një përfaqësues i zgjedhur nga studentët;
- e) tre përfaqësues të Personelit Akademik të emëruar nga Rektori.,

3. Anëtarët e Senatit Akademik, të cilët përfaqësojnë Personelin Akademik, i perkasin kategorise “Profesor”, ose zoterojne gradën shkencore “Doktor” (PhD), të fituar në një nga universitetet e Vendeve anëtare të Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OSBE) ose të Bashkimit Evropian (BE), si dhe përvojë mësimore prej së paku 10 vjetësh. Ata e ushtrojnë këtë detyrë pa pagesë, me përjashtim të rimbursimeve për shpenzimet e bëra.

4. Funksioni i anëtarit të Senatit është i papajtuëshëm me atë të anëtarit të Bordit të Administrimit. Ky funksion është i rinovueshëm, me kusht që të jenë po ato kritere emërimi apo zgjedhjeje. Për këdo, që për dy mandate radhazi ka mbajtur funksionin e anëtarit të Senatit, është e pamundur që, në fund të mandatit të dytë, të emërohet ose të rizgjidhet menjëherë për të njëjtin funksion.

Neni 13 – Funksionet e Senatit Akademik

1. Senati Akademik kryen funksionet si më poshtë:

- a) garanton autonominë e institucionit universitar, lirinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, të drejtat e studentëve dhe respektimin e parimeve që janë në bazë të veprimtarisë akademike;
- b) miraton, me shumicën e dy të tretave të anëtarëve të tij, Statutin, Kodin e Disiplinës, Kodin e Etikës së Universitetit dhe ndryshimet e tyre të mëvonshme;
- c) miraton rregullore dhe vendime të tjera në bazë të dispozitave të këtij Statuti;
- d) miraton programet e reja të studimit, të kërkimit shkencor si dhe ndryshimin dhe mbylljen e tyre, gjithnjë në përputhje me ruajtjen e ekuilibrit ekonomik-financiar të përcaktuar në projektbuxhetin vjetor të UniKZKM-së;
- e) propozon mbylljen e institucionit universitar, riorganizimin e tij, ndarjen në disa institucione apo shkritjen e tij me një institucion tjetër ose përfshirjen e tij në këtë të fundit;
- f) miraton hapjen, mbylljen ose riorganizimin e Njësive kryesore dhe të Njësive bazë;
- g) miraton planin vjetor të veprimtarisë akademike dhe të kërkimit shkencor dhe i propozon Bordit të Administrimit planin strategjik për zhvillimin e institucionit;
- h) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së Universitetit, të hartuar nga Këshilli i Rektoratit dhe ia përcjell atë, nëpërmjet Rektorit, Ministrisë përgjegjëse për Arsimin;



- i) përcakton linjat e përgjithshme të strukturës universitare, duke i propozuar Bordit të Administrimit personelin që do të punësohet në këtë strukturë;
- j) përcakton dhe aktivizon procedurat për vlerësimin e veprimtarisë didaktike dhe asaj kërkimore - shkencore të Personelit akademik, kriteret për përzgjedhjen, rekrutimin dhe shpërndarjen në Njësitë bazë të ndryshme;
- k) krijon Komisionet e Përhershme të UniKZKM-së dhe emëron anëtarët e propozuar nga Rektori;
- l) garanton sigurimin e nivelit të duhur të cilësisë në mësimdhënie, në kërkimin shkencor dhe në çdo veprimtari tjetër akademike;
- m) në fund të çdo viti akademik, organizon, në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, mbledhjen e përbashkët, ku, ndër të tjera, diskutohet për veprimtarinë e mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe për gjendjen e pronësisë dhe atë ekonomike - financiare;
- n) përcakton kërkesat lidhur me sanksionet që ka vendosur Komisioni i disiplinës, edhe me vendimin e Rektorit;
- o) emëron dy anëtarë të Këshillit të Etikës të propozuar nga Rektori;
- p) kryen çdo funksion tjetër që i është besuar atij nga Ligji dhe nga ky Statut.

2. Vendimet e përmendura në shkronjat b), e) dhe f) të paragrafit të mësipërm merren me pëlqimin e Bordit të Administrimit.

Neni 14 – Dispozita të veçanta mbi funksionimin e Senatit Akademik

1. Në mbledhjet e Senatit Akademik mund të ftohen, për disa pika të rendit të ditës dhe pa të drejtë vote, pedagogë, specialistë dhe ekspertë që nuk janë anëtarë të Senatit Akademik.

2. Senati Akademik mbledhet në selinë qendrore të Universitetit të paktën dy herë në vit dhe thirret nga Rektori me një njoftim në postën elektronike të anëtarëve të Senatit Akademik, të dërguar të paktën shtatë ditë para mbledhjes.

3. Vetëm në raste urgjente ose të jashtëzakonshme, të shprehura qartë në aktin e thirrjes, Senati Akademik mund të thirret nga Rektori me njoftim vetëm tre ditë dhe, nëse është e nevojshme, jo në selinë e institucionit.

4. Në rastin kur një vendim i veçantë që do të miratohet ka të bëjë me Rektoren, kompetencat e Rektorit i kalojnë përkohësisht Zevendësrektorit.

Neni 15 - Rektori

1. Rektori është autoriteti më i lartë akademik i cili, sipas Ligjit, përfaqëson UniKZKM-në për çështjet akademike dhe protokollare.

2. Rektori, emërohet nga Fondacioni ZKM, i cili e përzgjedh atë në radhët e personelit akademik të Institucionit, ose jashtë tij, i njohur për vlerat e tij shkencore, me përvojë të mëparshme në kryesimin, në drejtimin ose në koordinimin e organeve akademike, ose me aftësi të provuara organizative dhe menaxheriale.

3. Funksionet e Rektorit janë:

- a) drejton Senatin Akademik, thërret mbledhjet, vendos rendin e ditës dhe rregullon diskutimet përkatëse;
- b) garanton zbatimin e vendimeve, të masave dhe të kërkesave të Senatit Akademik dhe të Bordit të administrimit, në bazë të kompetencave të tyre përkatëse, duke u dhënë atyre llogari për punën e vet;



- c) merr pjesë, pa të drejtë vote, i ftuar me shkrim ose me iniciativën e tij, në mbledhjet e organeve kolegjiale të UniKZKM-së, tek të cilat ai nuk është anëtar;
- d) përgatit dhe dorëzon në Senatin Akademik dhe në Bordin e Administrimit projekt-aktet që duhet të miratohen nga ata veç e veç ose së bashku;
- e) u kërkon çdo informacion dhe sqarim, që e konsideron të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij, si Bordit të Administrimit, ashtu dhe të gjitha organeve të tjera, kolegjiale apo monokrate, të UniKZKM-së;
- f) emeron Personelin Akademik të UniKZKM-së, me anë të nënshkrimit të kontratave përkatëse të punës;
- g) organizon dhe bashkërendon, së bashku me Drejtuesit e Njësive kryesore dhe bazë, programet e studimit të të 3 cikleve si dhe ato të formimit të vazhduar, të trajnimit/kualifikimit dhe çdo veprimtari tjetër ku, në dobi të subjekteve të brendshme ose të jashtme të UniKZKM-së, përfshihet Personeli Akademik;
- h) nënshkruan diplomat e cikleve të ndryshme të studimit dhe certifikatat e tjera për tituj dhe grada të fituara në UniKZKM;
- i) zgjidh konfliktet që lindin rreth kompetencave ndërmjet organeve, drejtuesve akademikë të UniKZKM-së, me përjashtim të atyre ndërmjet Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit;
- l) kryen ose organizon kontrole në Njësitë e ndryshme për cilësinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, për sjelljen e personelit akademik dhe të atij kërkimor-shkencor dhe për çdo çështje tjetër me karakter akademik;
- m) i propozon Fondacionit ZKM, pasi të ketë marrë mendimin e Senatit Akademik, emërimin e Zëvendësrektorit, të Drejtuesve të Njësive kryesore (Dekanëve të Fakulteteve) dhe të Drejtuesve të Njësive bazë (Drejtuesve të Departamentit ose të Qendrave Kërkimore - shkencore);
- n) shpreh opinion detyrues për emërimin e Zëvendësdekanëve;
- o) i propozon Fondacionit ZKM një emërim të mundshëm në detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, sipas nenit 18;
- p) emëron të ngarkuarite tij, si brendaashtu dhe të jashtë personelit akademik të UniKZKM-së, për aspekte specifike dhe/ose për çështje të veçanta teknike, si dhe mundtë krijojë komitete dhe grupe pune për tematika që përfshijnë kompetencat dhe interesat shkencore të Personelit akademik;
- q) i propozon Senatit Akademik anëtarët e Komisioneve të përhershme të Universitetit dhe emëron ata të Njesisë së Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë (NJ.V.B.C.);
- r) zbaton vendimin përfundimtar të marrë nga Komisioni i Disiplinës ose, në rast ankimi, nga Senati Akademik, lidhur me masat disiplinore të ndërmarra ndaj anëtarëve të personelit akademik dhe atij kërkimor - shkencor, studentëve, si edhe ndaj autoriteteve akademike;
- s) propozon dy anëtarë të Bordit të Administrimit;
- t) emëron në Senatin Akademik, tërëpërfaqësues të Personelit Akademik;
- u) drejton Komisionin e Disiplinës;
- v) kryen çdo funksion tjetër që i është besuar atij nga Ligji dhe nga ky Statut.



4. Me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 11, paragrafi 10, Fondacioni ZKM mund të vendosë përfundimin e parakohshëm të mandatit të Rektorit, nëse konstaton se sjellja e tij është në konflikt të pariparueshëm me misionin, veprimtaritë dhe parimet statutore të UniKZKM-së, ose me vlerat frymëzuese dhe me interesat themelore të vetë Fondacioni ZKM, apo edhe kur dëmton imazhin dhe dinjitetin e këtyre institucioneve.

Neni 16 – Zëvendësrektori

1. Zëvendësrektori ushtron detyrat e parashikuara nga Ligji dhe ato që i janë besuar nga Rektori. Në rast mungese ose pamundësie të përkohshme të këtij të fundit, ai kryen funksionet si zëvendës i tij, duke nënshkruar aktet në kompetencë të Rektorit, me përjashtim të atyre që, sipas ligjit ose nga natyra e tyre, janë kompetenca ekskluzive dhe nuk mund të delegohen nga Rektori.

2. Zëvendësrektori është pjesë e Personelit Akademik të UniKZKM-së.

3. Marrëdhëniet e Zëvendësrektorit me organet e tjera të Këshillit të Rektoratit dhe të UniKZKM-së janë të përcaktuara më mirë në rregulloret e UniKZKM-së.

4. Zëvendësrektori emërohet nga Fondacioni ZKM me propozim të Rektorit dhe pas marrjes së mendimit pozitiv të Senatit Akademik. Me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 11, paragrafi 10, detyra e tij përfundon para kohe, me vendim të Fondacionit ZKM ose të Rektorit.

Neni 17 –Rektorati

1. Rektorati është një organ kolegjal që ndihmon Rektorin në kryerjen e funksioneve të tij. Ai përbëhet nga:

- a) Rektori;
- b) Zëvendësrektori;
- b) Administratori i UniKZKM-së;
- d) Sekretari i Përgjithshëm, në rastin kur është krijuar si autoritet drejtues.
- e) Drejtuesit akademikë të Njësive kryesore për çështje që kanë të bëjnë me kompetenca specifike të tyre ose kur ftohen nga vetë Rektori;

2. Rektorati:

- a) përgatit dhe i dorëzon Senatit Akademik Planin Strategjik për zhvillimin institucional, i cili bazohet në të dhënat e Njësive kryesore, të atyre bazë dhe të Administratorëve përkatës;
- b) i paraqet Bordit të Administrimit një Raport Vjetor të detajuar mbi veprimtaritë e përgjithshme të zhvilluara nga Universiteti;
- c) shpreh mendime dhe bën rekomandime, për t'ua dërguar Drejtuesve dhe Administratorëve të Njësive të lartpërmendura, për problemet që ai identifikon ose që i raportohen atij, rreth ushtrimit të veprimtarive të këtyre strukturave;
- d) shpreh një mendim, jo detyrues, me kërkesë të Rektorit, lidhur me konfliktet e përmendura në nenin 15, paragrafi 3, gërma i);
- e) i jep Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit informacion për nevoja të posaçme dhe harton propozime për vendime që duhet të marrin ata, sipas kompetencave përkatëse;
- f) ndihmon Rektorin lidhur me masat disiplinore.



3. Rektori mblidhet dhe kryesohet nga Rektori. Me autorizimin e shprehur të këtij të fundit, mund të kryesohet, përjashtimisht, nga Zëvendësrektori.

4. Me përjashtim të asaj që parashikohet nga Ligji dhe nga ky Statut, dispozitat e mëtejshme lidhur me kompetencat, organizimin dhe funksionimin e e Rektoratit përcaktohen nga Rregullorja e Përgjithshme e Universitetit (e referuar më poshtë si RR.P.U.) ose nga akte të tjera të brendshme dytësore.

Neni 18 – Sekretari i Përgjithshëm

1. Me propozim të Rektorit, Fondacioni ZKM mund të emërojë, si një autoritet tjetër drejtues, një Sekretar të Përgjithshëm, i cili është një personalitet i botës akademike, ose i njohur për vlerat dhe kualifikimin shkencor, mësimordhe organizativ.

2. Funksioni i tij zgjat katër vjet dhe është i rinovueshëm.

3. Sekretari i Përgjithshëm, në respekt të plotë të ligjit, të Statutit, të rregulloreve të tjera të brendshme dhe të çdo vendimi të organeve drejtuese të Universitetit, kryen funksionet që i janë caktuar në aktin e themelimit, mes të cilave përmendim:

- a) bashkëpunon me Rektoren për të zbatuar gjithçka që është brenda kompetencave të tij;
- b) e ndihmon atë që të verifikojë nëse janë respektuar procedurat dhe vendimet nga ana e anëtarëve të ndryshëm të personelit mësimdhënës dhe atij të kërkimit shkencor të Universitetit;
- c) ndjek veprimtari të veçanta të diktura nga Rektori për të promovuar efektivitetin dhe efikasitetin e tyre;
- d) mbështet Drejtuesit e Njësive kryesore (Dekanët e Fakulteteve) dhe të Njësive bazë (Drejtuesit e departamenteve ose të qendrave kërkimore - shkencore) për monitorimin dhe organizimin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore - shkencore, si dhe të ngarkuarve të Rektorit për kryerjen e veprimtarive të deleguara;
- e) merr pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e Senatit Akademik dhe të Këshillit të Rektoratit;
- f) merr pjesë, pa të drejtë vote, me ftesë të Drejtuesve përkatës, në mbledhjet e Komisioneve të ndryshme të përhershme të Universitetit dhe të Komisioneve të Njësive kryesore;
- g) kontribon, me kërkesë të Rektorit, në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve trajnuese të Universitetit;
- h) bashkëpunon në zhvillimin e procedurave të pranimeve të programet të studimit universitare, pasuniversitare dhe ato të formimit profesional.

Neni 19 – Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës promovon dhe shqyrton çështjet etike që lidhen me mësimdhënien, me kërkimin shkencor dhe me çdo veprimtari tjetër institucionale si dhe mbikëqyr zbatimin e Kodit të etikës të UniKZKM-së. Për këtë qëllim, ai ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë çdo informacion dhe sqarim të nevojshëm nga organet kolegjiale, nga autoritetet akademike dhe administrative dhe nga çdo pjesëtar i Personelit Akademik, dhe atij tekniko-administrativ të UniKZKM-së.

2. Përveç kësaj, Këshilli i etikës:

- a) u bën propozime organeve më të larta kolegjiale dhe autoriteteve monokrate të UniKZKM-së për rregullimin e marrëdhënieve midis parimeve etike dhe jetës



universitare, në bazë të misionit të UniKZKM-së, me qëllim respektimin e dinjitetit të njeriut dhe të të drejtave të çdo anëtari të komunitetit universitar;

- b) shpreh mendime, me kërkesë të këtyre organeve dhe autoriteteve, për çështje që kanë të bëjnë me etikën gjatë kryerjes së veprimtarive akademike dhe administrative dhe, në veçanti, për masat disiplinore në lidhje me shkeljen e Kodit të Etikës;
- c) diskuton çështje të sjella në vëmendjen e tij nga vetë subjektet institucionale;
- d) i raporton në mënyrë periodike, për së paku një herë në vit, Senatit Akademik dhe Rektorit për të dhënat e marra dhe për rezultatet e arritura.
- e) i propozon Bordit të Administrimit Kodine Etikës dhe ndryshimet e tij.

3. Këshilli i Etikës përbëhet nga pesë anëtarë, dy prej të cilëve zgjidhen nga Senati Akademik, me propozim të Rektorit dhe dy nga Bordi i Administrimit, mes personaliteteve, edhe jo akademike, por të vlerësuar për kulturën e tyre të spikatur, për përvojën e njohur profesionale dhe gjithsesi, për vlera të padiskutueshme morale dhe për korrektësi institucionale dhe/ose profesionale.

4. President i Këshillit është Arqipeshkvi i Tiranë-Durrësit ose i deleguari i tij.

Neni 20 – Asambleja e Personelit Akademik

1. Asambleja e Personelit Akademik përbëhet nga anëtarë të personelit akademik të njëjësive kryesore të UniKZKM-së të punësuar me kohë të plotë.

2. Ajo ushtron, ndër të tjera, kompetencat e mëposhtme:

- a) zgjedh anëtarëte Komisioneve të përhershme të Universitetit, me përjashtim të Komisionit të Disiplinës;
- b) kryen funksione të tjera të caktuara që i janë besuar asaj nga Senati Akademik ose që përcaktohen në aktet rregullatore.

Neni 21 – Komisionet e përhershme

1. Komisionet e përhershme të Universitetit dhe Komisionet e Përhershme të Njësive kryesore përbëhen prej jo më pak se pesë anëtarësh, të cilët e mbajnë këtë detyrë për dy vjet dhe mund të rizgjidhen. Ato janë:

- a) Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik;
- b) Komisioni për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”;
- c) Komisioni për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë
- d) Komisioni për mbarëvajtjen e veprimtarisë institucionale dhe marrëdhëniet me studentët.
- e) Komisioni i Disiplinës

2. *Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik, Komisioni për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë institucionale dhe Marrëdhëniet me studentët dhe Komisioni i Disiplinës funksionojnë vetëm në nivel institucional, Komisioni për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” funksionon vetëm në nivel Njësie Kryesore ndërsa Komisioni për Garantimin e Standarteve të Cilësisë të Universitetit dhe Programeve të Studimit funksionon si në nivel institucional ashtu dhe në nivel njësie kryesore. Ky i fundit bashkëpunon ngushtë me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë persa i perket hartimit dhe zbatimit të politikave institucionale lidhur me sigurimin e standarteve institucionale të cilësisë. Anëtarët*



e Komisioneve të përhershme si në nivel institucioni ashtu dhe në nivel njësie kryesore kanë mandat 2 vjeçar, të rinovueshëm.

3. Anëtarët e Komisioneve të përhershme të Universitetit dhe Kryetarët e tyre, me përjashtim të atyre të NJ.V.B.C., emërohen nga Senati Akademik me propozimin e Rektorit. Anëtarët e Komisioneve të përhershme të Njësive kryesore zgjidhen nga Asambleja e Personelit Akademik e secilës Njësi. Sekretari i Përgjithshëm, në rastin kur është krijuar si autoritet drejtues, mund të marrë pjesë, me ftesë të Kryetarëve përkatës, në punën e Komisioneve të Përhershme të Universitetit dhe të Njësive Bazë.

4. Në Komisionin për *Promovimin e Personelit Akademik*, bëjnë pjesë vetëm anëtarët e personelit akademik që mbajnë titullin “Profesor”, ndërsa në Komisionin për dhenien e grades “Doktor” anëtarët e tij kanë titujt “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”.

Në Komisionet e tjera ka edhe një përfaqësi të studentëve. Funkcionet e veçanta, profilet organizuese të Komisioneve, si dhe mundësia e krijimit të komisioneve të tjera rregullohen nga dispozita të posaçme rregullatore.

5. Komisioni i Disiplinës drejtohet nga Rektori. Brenda një muaji nga raportimi për shkelje disiplinore që mund të jenë bërë nga anëtarë të komunitetit universitar, nga autoritete akademike dhe administrative monokratike, komisioni duhet të përcaktojë sanksionet e mundshme disiplinore, mbas marrjes së mendimit të Këshillit të Rektoratit, dhe në rastin e ankesave për shkelje të Kodit Etik, edhe të Këshillit të Etikës. Komisioni i Disiplinës ndërhyt në rastet e mbarimit të parakohshëm të mandatit të parashikuara nga neni 11, paragrafi 10, gërma c), d), e). Garancitë procedurale të trajtimit të shkeljeve disiplinore paraqiten më hollësisht në dispozita të posaçme rregullatore.

Neni 22 – Dispozita për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJ.S.B.C.):

- a) Kontrollon ecurinë e menaxhimit të Universitetit dhe të aktiviteteve të tij për arritjen e objektivave institucionale;
- b) i paraqet Rektorit dhe Senatit Akademik një raport vjetor mbi mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe shërbimet e ofruara nga Universiteti, si dhe nivelin e funksionalitetit dhe efikasitetit të arritur nga strukturat e ndryshme organizative, duke marrë parasysh gjithashtu veprimtarinë e vitit paraardhës;
- c) informon Rektoratin mbi veprimtarinë e saj, iniciativat e ndërmarra dhe ecurinë e tyre;
- d) shpreh vleresime dhe i sugjeron Rektoratit propozime mbi objektivat e përcaktuar dhe shkallën e arritjes së tyre, mbi akreditimin institucional dhe të programeve të studimit nga institucionet kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- e) bashkepunon me Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe të programeve të Studimit lidhur me hartimin dhe zbatimin e politikave institucionale të sigurimit të standardeve institucionale të cilësisë si dhe për të çështjet e tjera që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë

Per realizimin e funksioneve të saj dhe garantimin e standardeve të cilësisë në drejtim të një performace sa më të mirë të veprimtarisë së universitetit, Nj.S.B.C. mund:



- a) të mbikëqyrë hartimin dhe shpërndarjen e pyetësorëve të ndryshëm për studentet dhe stafin akademik lidhur me programet e studimit dhe funksionimin institucional;
- b) të kryejë anketime për të njohur shkallën e punësimit të të diplomuarve në UniKZKM, duke vlerësuar përputhjen e programeve të studimit me nevojat e tregut;
- c) të dokumentojë produktin shkencor dhe realizimin e projekteve kërkimore - shkencore që përftohen nga veprimtaria e Personelit Akademik të punësuar në UniKZKM;
- d) të bëjë propozime dhe të shprehë mendime për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe të shërbimeve të tjera që u ofrohen studentëve;
- e) të kryejë detyra të tjera të përcaktuara me rregullore të veçanta, ose nga organet më të larta drejtuese akademike dhe administrative të vetë Universitetit, gjithnjë me synimin për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së Institucionit.

Neni 23 – Fakultetet

1. Fakultetet janë Njësi kryesore të Universitetit. Ato kanë për detyrë promovimin dhe bashkërendimin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore - shkencore, ofrimin e programeve të studimit të cikleve të ndryshme në fund të të cilave jepet titulli përkatës, si dhe organizimin e çdo veprimtarie tjetër trajnuese dhe shkencore të parashkuar me ligj, me Statut dhe me Rregullore.

2. Fakultetet përbëhen nga Departamentet dhe, në qoftë se janë ngritur, edhe nga Qendrat kërkimore - shkencore dhe, sidoqoftë, nga jo më pak se tri Njësi bazë.

3. Fakultetet miratojnë kriteret për pranimin e studentëve për secilin program studimi, mbi bazën e propozimeve të Departamenteve, në përputhje me dispozitat ligjore.

4. Emërtimi, fusha e saktë e kompetencës dhe profilet e tjera organizative dhe funksionale të Fakulteteve përcaktohen në RR.P.U. ose në akte të tjera të brendshme dytësore.

5. Dekani është autoriteti drejtues akademik me i lartëj Fakultetit ndërsa Dekanati është organi kolegjal mëllartë drejtues i tij.

6. Fakultetet e UniKZKM-së, në datën e miratimit të Statutit, janë:

- a) Fakulteti i *Mjekësisë*
- b) Fakulteti i *Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale*
- c) Fakulteti i *Farmacisë*
- d) Fakulteti i *Shkencave të Aplikuara*



Neni 24 – Dekani (ose Drejtuesi i Njësisë kryesore)

1. Dekani (ose Drejtuesi i Njësisë kryesore), si autoriteti më i lartë drejtues akademik i Fakultetit dhe si përfaqësuesi i tij, ka këto kompetenca:

- a) përgatit një raport vjetor mbi ecurinë e veprimtarive mësimore dhe kërkimore - shkencore të Fakultetit të cilin ia paraqet Rektorit. Përgatit raporte të tjera të ngjashme, me kërkesë të organeve të Fakultetit ose me iniciativën e tij;
- b) i propozon Rektorit, me iniciativën e tij ose me kërkesë të Njësisë bazë të Fakultetit, hapjen, mbylljen ose ndryshimet e këtyre të fundit, të *kurrikulave* të studimit dhe drejtimeve kërkimit shkencor të ndjekura prej tyre;
- c) informon Rektorin për mundësinë e hapjes së Qendrave kërkimore - shkencore, të programeve të studimit ose të shërbimeve të ndryshme për palët e treta, si dhe për



- pjesëmarrje në projekte që mund të realizohen në Shqipëri ose jashtë saj, me pjesëmarrjen e Personelit akademik të punësuar në Njësinë kryesore që ai drejton;
- d) me mbështetjen e Komisionit kompetent të Fakultetit (ose të Njësisë kryesore), kontrollon cilësinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, mbikqyr zbatimin e kontratave të punës që i përkasin Fakultetit (ose Njësisë kryesore), mbikqyr korrektësinë e sjelljeve brenda Fakultetit, si edhe përmbushjen e çdo angazhimi tjetër në strukturat e përfshira në të;
 - e) informon menjëherë Rektorin për çdo shkelje që është burim i përgjegjësisë civile, penale, etike dhe disiplinore të kryer brenda Fakultetit, propozon masat përkatëse dhe, në rastet më serioze, ndërprerjen e marrëdhënies së punës;
 - f) vendos për rastet e përjashtimit nga frekuentimi të studentëve të cikleve të ndryshme të studimit, të cilët bëjnë pjesë në Njësinë e tij, në rastet dhe sipas modaliteteve të përcaktuara më mirë në dispozitat rregullatore;
 - g) i propozon Rektorit që të lidhë marrëveshje me institucionet e tjera universitare ose të kulturës së lartë, dhe me organizma publikë dhe kompani private, kombëtare dhe të huaja, për të promovuar veçanërisht mobilitetin, trajnimin ose kualifikimin më të mirë të profesorëve, studiuesve, lektorëve dhe studentëve;
 - i) propozon çdo nismë tjetër që, në përputhje me misionin dhe interesat e Universitetit, mund të kontribuojë në rritjen sociale, kulturore dhe profesionale të anëtarëve të Fakultetit;
 - l) Pas marrjes së mendimit pozitiv të Rektorit dhe të Fondacionit ZKM, emëron Zëvendësdekanin dhe përcakton detyrat e tij.

2. Në zbatim të Ligjit dhe të këtij Statuti, dispozitat e mëtejshme mbi kompetencat e Dekanit (ose të Drejtuesit të Njësisë kryesore) dhe marrëdhëniet me organet e tjera të UniKZKM-së përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit ose në akte të tjera të brendshme dytësore.

3. Dekani (ose Drejtuesi i Njësisë kryesore) emërohet nga Fondacioni ZKM , me propozim të Rektorit; ai është anëtar i personelit akademik ose atij kërkimor - shkencor të Fakultetit, me kontratë pune me kohë të plotë dhe i përket kategorisë “Profesor”.

4. Me përjashtim të asaj që parashikohet në nenin 11, paragrafi 10, Rektori, mbasi ka marrë edhe mendimin e Rektoratit dhe të Bordit të Administrimit, i paraqet Fondacionit një kërkesë të motivuar për përfundimin e parakohshëm të mandatit të Dekanit për motivet e parashikuara në nenin 15, paragrafi 4. Rektori pezullon përkohësisht Dekanin nga funksionet e tij deri në vendimin përkatës të Fondacionit ZKM.

Neni 25 – Zëvendësdekanin

1. Zëvendësdekanin emërohet nga Dekani (ose Drejtuesii Njësisë kryesore), pas marrjes së mendimit pozitiv të Rektorit dhe të Fondacionit ZKM

2. Zëvendësdekanin zgjidhet nga radhët e Personelit akademik ose atij kërkimor - shkencor të Fakultetit me kontratë pune me kohë të plotë.

3. Numri, kompetencat dhe fusha e veprimit të Zëvendësdekanit përcaktohen me vendim të Dekanit.



4. Me përjashtim të asaj që parashikohet nga neni 11, paragrafi 10, dhe në bazë të rekomandimit eventual të Bordit të Administrimit dhe Rektorit, Dekani, mund të vendosë përfundimin e parakohshëm të mandatit të Zëvendësdekanit për arsyet e përcaktuara në nenin 15, paragrafi 4.

Neni 26 – Dekanati

Dekanati është një organ kolegjal që ndihmon Drejtuesin e Njesisë kryesore (Dekanim) në kryerjen e funksioneve të tij. Përbëhet nga:

- a) Dekani (ose Drejtuesi i Njesisë Kryesore);
- b) Zëvendësdekan;
- c) Administratori i Fakultetit (ose i Njesisë kryesore);
- d) Drejtuesit akademikë të Njësive bazë (Drejtuesit e Departamenteve dhe të Qendrave Kërkimore Shkencore) të Fakultetit (ose të Njesisë kryesore);
- e) një përfaqësues i studentëve i regjistruar në programet e studimit të Fakultetit (ose të Njesisë kryesore).

2. Dekanati:

- a) harton dhe i paraqet Këshillit të Rektoratit Planin Strategjik të Zhvillimit të Njesisë kryesore, në bazë të udhëzimeve të dhëna nga Dekani, nga Administratori i saj dhe nga Njësiti bazë të saj;
- b) koordinon veprimtaritë e Njësive bazë;
- c) i jep Këshillit të Rektoratit ose organizmave të tjerë kompetente informacion për nevoja të posaçme dhe harton propozime për vendime që duhen marrë.

3. Dekanati thirret dhe drejtohet nga Dekani. Ai mund të drejtohet në raste të jashtëzakonshme nga Zëvendësdekan, i autorizuar me shkrim nga Dekani.

4. Me përjashtim të rasteve të parashikuara nga Ligji dhe nga ky Statut, dispozitat në lidhje me kompetencat, me organizimin dhe me funksionimin e Dekanatit (ose të Këshillit të Fakultetit) përcaktohen në rregulloret e brendshme.

Neni 27 – Njësia bazë

1. Njësiti bazë janë strukturat më të vogla të UniKZKM-s të cilat nuk mund të ndahen më tej.
2. Njësiti bazë mund të jenë Departamente dhe Qendra kërkimore - shkencore të cilat krijojnë për një numër jo më pak se tre, një Njësi kryesore.



Neni 28 – Departamenti

1. Departamenti është Njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e mësimdhënies dhe të punës kërkimore - shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore përkatëse.

2. Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë të punësuar me kohë të plotë, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë.

3. Departamenti propozon programet e studimit dhe të kërkimit shkencor në përputhje me kapacitetet akademike të anëtarëve të tij, të infrastrukturës dhe të burimeve të tij, sipas standardeve të caktuara të cilësisë. Për këtë qëllim, departamenti menaxhon një fond bazë financiar dhe, po të lindë nevoja, një pjesë të fondeve të projekteve të tij të kërkimit shkencor dhe të të ardhurave nga shërbimet e ofruara prej tij palëve të treta. Departamenti mund të organizohet në grupe mësimore ose në grupe kërkimore - shkencore të përhershme ose të përkohshme.



4. Departamenti kryen edhe funksionet e treguara më poshtë:
- propozon ose shpreh mendimin për programet e studimit dhe të kërkimit shkencor, për shpërndarjen e ngarkesës mësimore, për rekrutimin e Personelit Akademik të brendshëm dhe për caktimin e titujve dhe të gradave shkencore;
 - propozon Dekanit hapjen, mbylljen dhe ndryshimin e programeve të studimit të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, si dhe zgjerimin, modifikimin e organikës dhe të strukturave të tij;
 - i jep Këshillit të Rektoratit, me iniciativën e tij ose mbas kërkesës me shkrim të këtij të fundit, çdo të dhënë të nevojshme për përgatitjen e planit strategjik të zhvillimit institucional;
 - jep informacion për nevoja të veçanta dhe harton projek-tvendime, të cilat ia paraqet Dekanit dhe / ose Dekanatit.

5. Me përjashtim të rasteve të parashikuara nga Ligji dhe nga ky Statut, dispozitat e mëtejshme lidhur me kompetencat, organizimin dhe funksionimin e Departamentit përcaktohen nga Rregullorja e Përgjithshme e Universitetit ose nga akte të tjera të brendshme dytësore.

Neni 29 – Qendra kërkimore - shkencore

- Qendra Kërkimore - shkencore është një Njësi bazë, e cila ka kompetenca të njëjta me ato të Departamentit vetëm për ato aspekte specifike që lidhen me fushate saj kërkimore - shkencore.
- Qendra mund të mbështesë realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” dhe “Doktoratë”, të ofruara nga Departamentet e Fakultetit përkatës ose të fakulteteve të tjera.
- Struktura, përbërja, funksionimi dhe drejtimi i Qendrës përcaktohen në statutin dhe në aktet e tjera të UniKZKM-së.

Neni 30 – Drejtuesi i Njesisë bazë

- Drejtuesi i një Njesisë bazë është Drejtuesi i një Departamenti ose i një Qendre kërkimore - shkencore. Ai është autoriteti drejtues akademik i asaj Njesisë dhe e përfaqëson atë. Ai emërohet nga Rektori, pasi ka marrë mendimin e Dekanit (Drejtuesit të Njesisë kryesore). Rektori, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 11, paragrafi 10, mund të vendosë mbarimin e parakohshëm të mandatit të Drejtuesit të Njesisë bazë për motivet e përcaktuara në nenin 15, paragrafi 4.
- Drejtuesi i Njesisë bazë duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në nenin 12, paragrafi 3.
- Funksionet e veçanta të Drejtuesit të Njesisë bazë përcaktohen nga Rregullorja e Universitetit.

SEKSIONI II ORGANIZIMI ADMINISTRATIV

Neni 31 – Bordi i Administrimit: përbërja

- Bordi i Administrimit është organi më i lartë drejtuesadministrativ i UniKZKM-së. Ai garanton përmbushjen e misionit të institucionit, paanshmërinë dhe mbarëvajtjen e administrimit të tij, si dhe menaxhimin e duhur ekonomik-financiar dhe pasuror.
- Anëtarët e tij nuk duhet të jenë në asnjërin prej situatave të papajtueshmërisë të parashikuara nga Ligji, e as në konflikt interesi, qoftë dhe vetëm potencial, me çfarëdo profili të misionit të institucionit të arsimit të lartë ose të çdo veprimtarie të kryer nga vetë institucioni. Detyra e anëtarit të Bordit të Administrimit është e rinovueshme pa kufij në numrin e mandateve. Anetaret e Senatit,



Drejtuesit e Njësive kryesore, drejtuesit e Njësive bazë, dhe çdo punonjës tjetër ose person përgjegjës i UniKZKM-së, me funksione drejtuese, nuk mund të jenë anëtarë të Bordit të Administrimit, por mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e tij ashtu si edhe subjekte të tjera nga jashtë Universitetit, pa të drejtë vote.

3. Bordi i Administrimit ka në përbërje 9 anëtarë. Kryetari dhe anëtarët e tjerë të Bordit të Administrimit emërohen nga Fondacioni ZKM. Dy prej tyre propozohen nga Rektori, i cili i zgjedh ata nga radhët e atyre që përmbushin kriteret e parashikuara në nenin 12, paragrafi 3.

Neni 32 – Funksionet e Bordit të Administrimit

Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore:

- a) kontribuon në përmbushjen e misionit të Universitetit, garanton qëndrueshmërinë e tij ekonomike-financiare dhe mbikëqyr përdorimin e të ardhurave dhe gjendjen e përgjithshme financiare;
- b) me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik për zhvillimin e Universitetit, totalin e shpenzimeve, buxhetin preventiv vjetor dhe buxhetin afatmesëm, si dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
- c) vlerëson paraprakisht mbylljen e institucionit universitar, riorganizimin e tij, ndarjen e tij në disa institucione, shkriren ose bashkimin e tij me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
- d) miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e Njësive kryesore ose të atyre bazë;
- e) përcakton, në përputhje me rregulloret e UniKZKM-së, kriteret dhe procedurat për shpërndarjen e të ardhurave dhe për punësimin e personave në funksione drejtuese si dhe të Personelit tekniko-administrativ;
- f) përcakton, në përputhje me parashikimet e buxhetit, ndryshimet në lidhje me organikën, shtimin ose zvogëlimin e Personelit akademik dhe të Personelit tekniko-administrativ, pagat dhe kompensimet e çdo punonjësi brenda institucionit, tarifat e shkollimit dhe kontributet e tjera financiare nga ana e studentëve dhe të tëregjistruarve të tjerë në programet e studimit që zhvillohen nga Universiteti, përjashtimin eventual të tyre, si dhe shpërblime dhe bursa për më të mirët dhe/ose për ata në nevojë;
- g) verifikon qëndrueshmërinë financiare të iniciativave të propozuara nga organet e brendshme të Universitetit apo nga subjekte të jashtme, të cilat, sidoqoftë, përfshihen në strukturat dhe / ose në Personelin e saj;
- h) me propozim të Senatit Akademik, vendos në lidhje me personelin që do të punësohet në institucionin universitar;
- i) miraton Rregulloren e vet të brendshme dhe shpreh opinionin e tij jo-detyrues mbi skemat e rregulloreve të Universitetit;
- l) emëron dhe shkarkon, me vendim të prerë, Administratorin e Universitetit;
- m) miraton raportin vjetor mbi veprimtarinë e përgjithshme të universitetit, të hartuar nga Këshilli i Rektoratit;
- n) miraton, së bashku me Senatit Akademik dhe me shumicën e kualifikuar të dy të tretave të anëtarëve të tij, Statutin, Kodin e Disiplinës, Kodin e Etikës dhe ndryshimet e mëvonshme të tyre;
- o) përcakton kërkesat për sanksionet e vendosura nga Komisioni i Disiplinës dhe të caktuara nga Administratori i Universitetit;



- p) emëron dy anëtarë të Këshillit të Etikës;
- q) kryen çdo funksion tjetër të caktuar nga Ligji dhe nga ky Statut.

Neni 33 – Dispozita të veçanta për disa aspekte ekonomike-financiare të Bordit të Administrimit

1. Fondi bazë financiar, shpenzimet për funksionimin e organit, duke përfshirë kompensimet e marra nga anëtarët e saj, përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit ose në akte të tjera të brendshme dytësore dhe përfshihen si zëra pasivë në një zë të veçantë në pasqyrat financiare të UniKZKM-së.

2. Bordi i Administrimit informon periodikisht, për së paku një herë në vit, Senatit Akademik dhe Rektorin për menaxhimin ekonomik-financiar, për gjendjen pasurore dhe për çdo çështje tjetër që ka të bëjë me buxhetin e Universitetit.

Neni 34 – Administratori i Universitetit

1. Administratori i UniKZKM-së është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjësi kryesor për mirëfunksionimin financiar të institucionit. Ai ndjek zbatimin e vendimeve të Bordit të Administrimit dhe është përfaqësuesi ligjor i Universitetit për çështjet administrative dhe financiare.

2. Bordi i Administrimit, me shumicë të kualifikuar të dy të tretave të anëtarëve të saj, emëron dhe shkarkon Administratorin dhe vendos për kohëzgjatjen e mandatit të tij, jo më shumë se për katër vjet, por të rinovueshëm. Kriteret minimale për të qenë Administrator janë arsimi i lartë, së paku në nivelin “Master i Shkencave” në fushën e drejtësisë ose të ekonomisë dhe përvojë pune, së paku shtatë vjet, në fushën e menaxhimit.

3. Administratori i Universitetit nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër akademik apo administrativ brenda UniKZKM-së.

4. Administratori jep të gjitha sqarimet dhe informacionet e kërkuara nga Bordi i Administrimit, nga Senati Akademik dhe nga Rektori; çdo tre muaj, ai i raporton Bordit të Administrimit ecurinë e punës së tij; merr pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit Akademik, të cilëve, në fund të vitit, u paraqet një raport të detajuar mbi veprimtarinë dhe situatën ekonomike-financiare të Universitetit.

5. Administratori kryen edhe funksione të tjera të renditura si më poshtë:

- a) përgatit projektbuxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të Njësive kryesore dhe të Njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në planin buxhetor afatmesëm, si dhe ndjek dhe kontrollon nëse strukturat e Universitetit respektojnë parashikimet përkatëse ekonomike-financiare;
- b) i propozon Bordit të Administrimit kriteret për menaxhimin e burimeve financiare dhe materiale dhe mbikëqyr nëse shpërndarja dhe përdorimi i tyre i mëvonshëm bëhet në bazë të vendimit të Bordit të Administrimit;
- c) është përgjegjës për zbatimin e të gjitha vendimeve të Bordit të Administrimit dhe bashkë-përgjegjës për vendimet e Senatit Akademik me karakter financiar dhe administrativ;
- d) bashkëpunon me strukturat e Universitetit dhe autoritetet e tjera për çështjet e administrimit të përditshëm;



- e) emëron dhe shkarkon administratorët e Njësive kryesore dhe të Njësive bazë, pas miratimit të Bordit të Administrimit;
- h) plotëson kërkesat e Rektorit, me qëllim parësor përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;
- i) i paraqet Bordit të Administrimit çdo propozim që e konsideron të dobishëm për kryerjen sa më mirë të menaxhimit administrativ dhe financiar, bashkëpunon me Kryetarin e tij sidomos për caktimin e rendit të ditës të mbledhjeve të thirrura nga ky i fundit dhe për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm;
- l) merr pjesë, pa të drejtë vote, i thirrur me një ftesë me shkrim ose me iniciativë të vet, në mbledhjet e organeve kolegjiale të UniKZKM-së, tek të cilat ai nuk është anëtar;
- o) zbaton vendimin e prerë, të marrë nga Komisioni i disiplinës, ose në rast ankimi, nga Bordi i Administrimit, lidhur me procedurat disiplinore të ngritura ndaj autoriteteve administrative dhe anëtarëve të Personelit tekniko-administrativ;

6. Funksione të tjera të Administratorit përcaktohen në rregulloret e Universitetit.

Neni 35 – Administratori i Fakultetit (ose i Njesisë kryesore)

1. Administratori i secilit Fakultet (ose i secilës Njësi kryesore) është autoriteti më i lartë administrativ dhe është përgjegjësi kryesor për mirëfunksionimin financiar dhe administrativ të vetë Fakultetit (Njesisë).

2. Administratori i Fakultetit (ose i Njesisë kryesore) emërohet dhe shkarkohet nga Administratori i Universitetit, pas marrjes së vendimit nga Bordi i Administrimit. Kriteret minimale për të qenë Administrator i Fakultetit janë arsimiti i lartë, së paku në nivelin “Master i shkencave” në fushën e drejtësisë ose të ekonomisë dhe përvojë pune së paku pesë vjet në fushën e menaxhimit.

3. Administratori i Njesisë kryesore nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër administrativ apo akademik brenda UniKZKM-së.

4. Funksionet e Administratorit të Fakultetit (ose të Njesisë kryesore) janë:

- a) realizon administrimin e përditshëm ekonomik dhe financiar të Fakultetit;
- b) mbikëqyr dhe kontrollon përdorimin korrekt të burimeve financiare në dispozicion të Fakultetit (ose të Njesisë kryesore);
- c) përmbush kërkesat e Dekanit, dhe është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të tij me qëllim parësor përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;
- d) bashkëpunon me autoritetet administrative dhe me organet drejtuese të Njesisë kryesore për çështjet themelore të administrimit të saj.

KREU I TRETË PERSONELI I INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË

Neni 36 – Personeli i Institucionit të arsimit të lartë

1. UniKZKM-ja është një bashkësi e përbërë nga personeli akademik, personeli ndihmes akademik dhe nga personeli administrativ që veprojnë në fushën e arsimit të lartë, të kërkimit shkencor, të trajnimit dhe ku respektohet individi dhe liritë e tij personale, veprohet në të mirë të interesit të përgjithshëm dhe sipas parimit të solidaritetit.

2. Të gjithë anëtarëve të çdo njësie u kërkohet, gjithashtu, të njohin dhe të përmbushin detyrat e tyre etike, personale dhe profesionale, të punojnë në përputhje me misionin dhe parimet themelore



të Institucionit, të frymëzohen në sjelljen e tyre nga kritere të ndershmërisë, korrektësisë, bashkëpunimit të sinqertë dhe efikas.

3. Rregulloret e posaçme dhe Kodi i Disiplinës e përcaktojnë më mirë *statusin*, të drejtat dhe detyrat, si dhe përgjegjësinë disiplinore dhe garancitë procedurale lidhur me secilin anëtar të bashkësisë së UniKZKM-së.

SEKSIONI I PERSONELI AKADEMIK

Neni 37 – Veprimtaria dhe *statusi* i Personelit akademik

1. Personeli Akademik i UniKZKM-së zhvillon kryesisht veprimtari didaktike dhe kërkimore – shkencore në autonomi të plotë, pa asnjë lloj kushtëzimi, në përputhje me vlerat themelore të UniKZKM-së, si dhe me dispozitat përkatëse ligjore, statutore dhe rregullatore të fushës përkatëse. Ai mund të kryejë gjithashtu veprimtari institucionale në organet drejtuese dhe çdo veprimtari tjetër, të tilla si, këshillimi për studentët ose mbështetja për shërbimet dhe strukturat administrative, të cilat në përputhje me misionin dhe parimet themelore të përcaktuara në këtë Statut, janë në funksion ose të ndërlidhura me veprimtaritë kryesore.

2. Personeli Akademik gëzon *status* të veçantë sipas dispozitave të Kodit të Punës dhe Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, si dhe sipas dispozitave specifike të Statutit dhe Rregulloreve të UniKZKM-së. Aspektet e mëtejshme të këtij *statusi*, veçanërisht në lidhje me trajtimin financiar, mund të përcaktohen nga Bordi i Administrimit.

3. I gjithë personeli akademik, para se të marrë detyrën, duhet të informohet për karakterin katolik të institucionit dhe për përgjegjësinë që ai ka për respektimin e identitetit të UniKZKM-së.

Neni 38 – Kategoritë e Personelit akademik

1. Personeli Akademik ndahet sipas kategorive të treguara më poshtë:

- a) Profesorë;
- b) Lektorë;
- c) Asistent - lektorë;

2. Anëtarët e personelit akademik të kategorise “Profesor” janë të punësuar me kohë të plotë dhe mund të jenë drejtues të grupeve të caktuara didaktike dhe / ose kërkimore - shkencore dhe udhëheqës të veprimtarive kërkimore - shkencore ose të projekteve shkencore. Në kategorinë “Profesorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë “Profesor” ose “Profesor i asociuar”.

3. “Lektorët” kryejnë veprimtari mësimore dhe kërkimore - shkencore dhe janë të punësuar me kohë të plotë. Mbajnë gradën shkencore “Doktor” dhe kanë së paku tri vite përvojë në mësimdhënie para ose pas fitimit të kësaj grade. Në mungesë të “Profesorëve”, ata mund të marrin të njëjtat përgjegjësi për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore - shkencore.

4. “Asistentë lektorët” kryejnë, me kohë të caktuar, veprimtari mësimore dhe kërkimore - shkencore, në mbështetje të veprimtarive të zhvilluara nga Profesorët dhe lektorët. Asistent-lektorët duhet të kenë së paku diplomën “Master i shkencave”. Ata mund të punësohen gjithashtu me kohë të plotë nëse kryejnë edhe funksione të tjera brenda institucionit, si p.sh., teknikët e laboratorit dhe anëtarët e Personelit shëndetësor.



5. “Pedagogët e ftuar” janë Profesorë universiteti dhe figuratë tjera të rëndësishme në botën e shkencës, kulturës, të artit, të politikës, të ekonomisë dhe të sipërmarrjes, të profesioneve dhe të administratës publike, shqiptarë apo të huaj, të cilët, falë përvojës dhe zotësisë tekniko-shkencore të fituara, mund të kontribuojnë në plotësimin e nevojave didaktike dhe kërkimore - shkencore të Njësive bazë të UniKZKM-së.

6. Pedagogët e ftuar nga Rektori miratohen dhe caktohen, sipas kompetencave të tyre dhe nevojave të veçanta didaktike e kërkimore - shkencore të UniKZKM-së, në një ose më shumë Njësi specifike bazë. Kriteret e mëtejshme, duke përfshirë edhe ato procedurale, për zgjedhjen, emërimin dhe punësimin e Personelit Akademik të ftuar, parashikohen në Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit, ose në akte të tjera të brendshme dytësore, si dhe në marrëveshjet me Universitete të tjera ose me institucione të tjera publike ose private në partneritet me UniKZKM-në.

7. Punësimi i pedagogëve tëftuar bazohet në Statutin dhe në rregulloret specifike të institucionit, të detajuara më tej nga organet kompetente për caktimin e linjave të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Shpenzimet dhe shpërblimet përkatëse për Personelin akademik të ftuar përfshihen në zëra të veçantë të buxhetit të institucionit.

Neni 39 – Viti akademik sabatik

1. Pjesëtarët e personelit akademik të kategorive “Profesor” dhe “Lektor”, me miratimin paraprak të Njesisë bazë, kanë të drejtë të shkëputen nga kryerja e veprimtarive të tyre akademike-institucionale për qëllime studimi dhe kërkimi shkencor që synon rritjen e kompetencave të tyre tekniko - shkencore një herë në 7 vjet dhe për një periudhë jo më të gjatë se një vit.

2. Kërkesa miratohet nga Rektori pas mendimit të shprehur me shkrim të Bordit të Administrimit, i cili mund të vendosë kushte të caktuara sipas dispozitave të posaçme të RR.P.U. ose akteve të tjera dytësore.

Neni 40 – Shpërblimet e Personelit Akademik

1. Kriteret për punësimin, shpërblimin dhe/ose kompensimin e Personelit Akademik përcaktohen nga Bordi i Administrimit, me propozim të Rektorit dhe të Administratorit të Universitetit.

2. Shpërblimi për të gjitha kategoritë e Personelit Akademik, të përmendur në nenin 38, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, miratohet nga Bordi i Administrimit me propozimin e Rektorit dhe të Administratorit të Universitetit.

3. Kontrata e punës duhet të përmbajë të gjitha informacionet në lidhje me shpërblimin, me mënyrat dhe me kohën e punës, me të drejtat dhe me detyrat që lidhen me mësimdhënien dhe me kërkimin shkencor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Shpërblimi për veprimtaritë plotësuese dhe jashtë orarit, si dhe pagesat e udhëtimit për veprimtaritë e kryera jashtë vendit, përcaktohen me vendim të veçantë të Administratorit, me miratimin e Rektorit, në përputhje me legjislacionin aktual dhe me kuadrin e përgjithshëm të pagave të përcaktuara nga Bordi i Administrimit. Këto shuma përcaktohen në kontratën e punës.



SEKSIONI II
PERSONELI TEKNIKO – ADMINISTRATIV

Neni 41 – Personeli tekniko – administrativ

1. Në bazë të ligjeve përkatëse dhe veçanërisht të Kodit të Punës, kontratat e punës, afatet dhe orët e punës, nivelet e pagave dhe çdo aspekt tjetër që ka të bëjë me personelin joakademik të UniKZKM-së, përcaktohet nga Bordi i Administrimit.

2. Akte specifike rregullatore të UniKZKM-së përcaktojnë rregullat e hollësishme për punësimin, marrëdhëniet në punë dhe trajtimin ligjor dhe ekonomik të Personelit tekniko-administrativ.

SEKSIONI III
STUDENTËT

Neni 42 – Statusi juridik i studentëve

1. Studenti konsiderohet si i tillë pas plotësimit të të gjitha formaliteteve të nevojshme për regjistrimin në UniKZKM. Kualifikimi “student” përfundon me marrjen e diplomës. Statusi “student” humbet edhe në rastet e mospagimit të pagesave ose të detyrimeve të tjera universitare, të braktisjes vullnetare të studimeve ose të dëbimit nga Universiteti.

2. Studenti duhet të përmbushë të gjitha detyrat dhe detyrimet e tij që burojnë nga Ligji, nga programi i studimit të zgjedhur, nga Statuti, Kodi i etikës, rregulloret e brendshme dhe aktet e tjera të organeve universitare.

3. Në rastin kur një student nuk kryen detyrat e tij, nuk përmbush detyrimet e tij, shkel rregullat e Universitetit ose ato të Kodit të etikës, atëherë, ai u nënshtrohet masave disiplinore sipas dispozitave specifike të Rregullores së Përgjithshme të Universitetit, të Kodit të disiplinës dhe akteve të tjera rregullatore.

4. Studentët, ndër të tjera, kanë të drejtë:

- a) të përdorin infrastrukturën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor që u është vënë në dispozicion;
- b) të përfitojnë nga shërbimet e aktivizuara dhe nga hapësirat e përbashkëta ose të rezervuara për ata nga Universiteti;
- c) të përfaqësohen në organet e Universitetit sipas përcaktimeve në këtë Statut dhe në RR.P.U. ose në akte të tjera të brendshme dytësore;
- d) të përfitojnë nga benefitet e të drejtës për arsimim;
- e) të kenë siguracion për risqet që kanë të bëjnë me aksidentet që ndodhin brenda Universitetit ose për riskun e ndërprerjes së veprimtarive mësimore, si dhe për risqe të tjera të përcaktuara nga organet kompetente të Ministrisë përgjegjëse;
- f) të pajisen me Kartën e studentit me të cilën përfitojnë edhe shërbime me çmime të reduktuara, siç përcaktohet në ligj;
- g) të krijojnë shoqata studentore të cilave mund t’u rezervohen ambiente të posaçme, struktura dhe fonde për nisma në përputhje me misionin dhe me veprimtaritë e tjera të UniKZKM-së dhe sipas procedurave të specifikuara në dispozita të posaçme rregullatore.

5. Studentët, ndër të tjera, kanë për detyrë:



- a) të respektojnë Ligjin, Statutin, Kodin e etikës dhe rregulloret e tjera të brendshme të UniKZKM-së, si dhe çdo vendim tjetër detyrues të marrë nga organet akademike dhe administrative;
- b) t'u kushtojnë vëmendjen e duhur studimeve të tyre dhe të marrin pjesë aktivisht në veprimtaritë akademike;
- c) të paguajnë rregullisht tarifat përkatëse edhe për shërbimet që u ofrohen nga Institucioni;
- d) të sillen gjithmonë në përputhje me *statusin* e tyre, të respektojnë rolin, të drejtat dhe nevojat e të tjerëve, si dhe të sillen në përputhje me natyrën, me misionin, me parimet dhe me qëllimet e tjera themelore të Institucionit dhe të strukturës së veçantë ku bëjnë pjesë.

Neni 43 – Mbështetje për studimet

1. UniKZKM-ja promovon mbështetjen e studimeve përmes veprimeve dhe shërbimeve në dobi të studentëve, në përputhje me burimet e disponueshme financiare dhe strukturore. Për këtë qëllim mund të nënshkruajë marrëveshje dhe konvencione me organizma publike dhe organizata private në pajtim me ligjin dhe me këtë Statut.

2. Universiteti promovon cilësinë dhe meritat në studime dhe ofron çmime dhe kontribute për studentët më të mirë. Ai mbështet gjithashtu të drejtën për arsimim të studentëve nga shtresa sociale në nevojë, nëpërmjet përjashtimit nga detyrimi ekonomik. Kriteret për të përfutur çmime ose përjashtime nga detyrimi ekonomik, si dhe shuma përkatëse, përcaktohen nga Bordi i Administrimit, me kërkesë të veçantë nga Rektori.

3. Universiteti, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndërmerr masat e nevojshme për t'iu përgjigjur të drejtës së personave me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në veprimtaritë e ofruara nga Universiteti.

Neni 44 – Këshillate Studentëve

1. Këshilli Studentor i Universitetit zgjidhet çdo dy vjet. Përbërja dhe procedurat zgjedhore përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit dhe në akte të tjera të brendshme dytësore. Ka të drejtë të jetë anëtar i tij, përfaqësuesi i studentëve pranë Senatit Akademik (dhe studentët që janë anëtarë të organeve të tjera akademike). Këshilla studentore mund të krijohen gjithashtu në çdo Njësi kryesore me së paku njëqind anëtarë, me kohëzgjatje dy vjet.

2. Të gjitha Këshillat janë organizata autonome që nuk kanë synime politike, nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike, as nuk mund të lidhen ose financohen drejtpërdrejt dhe vazhdimisht nga shoqata politike apo grupe biznesi. Ata promovojnë pjesëmarrjen e anëtarëve dhe koordinojnë përfaqësimin e studentëve të Universitetit, në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të Studentëve dhe Këshillat e institucioneve të tjera arsimore. Përveç kësaj, ata shprehin mendime dhe propozime për planet dhe programet e studimeve, për problematikat didaktike, për cilësinë e shërbimeve të ofruara, për përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe të kontributeve të tjera financiare për studentët, për bilancet e UniKZKM-së dhe për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, sociale, artistike, sportive etj.

3. Organet dhe strukturat e UniKZKM-së, veçanërisht Garantuesi i Studentëve, ndihmojnë, Këshillin e Studentëve dhe Shoqatën e të diplomuarve në veprimtaritë e tyre kulturore, sociale,



sportive dhe zbavitëse, edhe për çështje logjistike, nëpërmjet vënies në dispozicion të strukturave dhe të hapësirave të përshtatshme për zhvillimin e tyre.

4. Këshillat e Studentëve të UniKZKM-së kanë Statutin e tyre dhe, eventualisht, rregulloret e tyre në përputhje me Statutin, të miratuara me vendim të Rektorit, pas marrjes së mendimit të Senatit Akademik.

Neni 45 – Këshillimi i Karrierës

UniKZKM-ja ofron shërbimin e keshillimit të karrierës studentore për maturantët në fazën e zgjedhjes së studimeve universitare dhe për studentët e saj gjatë studimeve universitare.

Për të diplomuarit e vet, UniKZKM ofron gjithashtu shërbim të keshillimit të karrierës profesionale dhe të orientimit në drejtim të punësimit sa më shpejt të tyre, të pjesëmarrjes aktive në jetën profesionale dhe në drejtim të kualifikimit të vazhdueshëm të tyre.

Gjithashtu universiteti bashkëpunon me shoqatat e biznesit dhe të sipërmarrjes, shoqatat profesionale dhe institucionet e ndryshme për të lehtësuar integrimin në botën e punës të të gjithë atyre që ndjekin programet e studimit, ato të formimit të vazhduar, të kualifikimit/trajnitimit të organizuara nga UniKZKM-ja.

Neni 46 – Garantuesi i studentëve

1. Garantuesi i Studentëve zgjidhet nga Këshilli i Studentëve nga radhët e Personelit Akademik, ku përfshihet edhe personeli akademik i ftuar i UniKZKM-së, dhe emërohet nga Rektori. Ai gëzon të drejtën e mbështetjes së përfaqësuesit të studentëve që është edhe anëtar i Senatit Akademik.

2. Garantuesi ofron, me nismën e tij ose mbasi i është bërë kërkesë, asistencë për studentët dhe jep sqarime për të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe mbi dispozitat e përgjithshme të sistemit universitar dhe mbi rregullat e brendshme specifike të UniKZKM-së. Ai gjithashtu informon menjëherë Rektorin dhe çdo organ tjetër kompetent për problemet që ka hasur drejtpërdrejt ose që ia kanë referuar studentët, në lidhje me zhvillimin e rregullt të veprimtarive mësimore, përdorimin korrekt të shërbimeve për studentët dhe, më gjerësisht, për mbrojtjen e të drejtave të vetë studentëve.

3. Kompetenca të tjera, aspekte organizative dhe funksionale të Garantuesit të Studentëve rregullohen me norma të posaçme.

KREU I KATËRT ORGANIZIMI I STUDIMEVE

Neni 47 – Programet e Studimit

1. Të gjitha programet e studimit kërkojnë pjesëmarrje të detyrueshme. Ata mund të jenë me kohë të plotë dhe me kohë të zgjatur. Këto të fundit mund të ofrohen për një periudhë nga një deri në dy vjeçare, vetëm për programet mësimore të ciklit të dytë *Master profesional* ose të ciklit të tretë *Master ekzekutiv*.

2. Programet e studimit përfundojnë me marrjen e diplomës përkatëse, siç parashikohet në nenin 48. Modalitetet dhe koha e pjesëmarrjes, kriteret për kryerjen e provimeve dhe të kontrolleve të tjera lidhur me vlerësimin dhe diplomimin e studenteve dhe çdo dispozitë tjetër lidhur me studimet, duke përfshirë edhe ato me kohë të zgjatur, parashikohen në rregulloret e posaçme.

3. Programet e studimit, programet lejore dhe mënyrat e hapjes dhe të menaxhimit të programeve i referohen ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të sistemit universitar shqiptar, si dhe, kur



bëhet fjalë për programe të përbashkëta studimi, të finalizuar me diploma të përbashkëta ose të dyfishta, ato i referohen niveleve analoge të Universiteteve të huaja me të cilat UniKZKM ka lidhur marrëveshje dhe i zhvillon bashkarisht. Programet e studimit, të licensuara dhe të akredituara rregullisht, bëhen të njohura dhe shpallen përpara se të aktivizohen procedurat për pranimin e studentëve.

4. Programet e përbashkëta të studimit që ofrojnë diploma të përbashkëta ose të dyfishta duhet të jenë në përputhje, përveçse me dispozitat ligjore, statute dhe rregullatore, edhe me dispozitat e parashikuara në marrëveshjet specifike të nënshkuara me Universitetet shqiptare ose të huaja në partneritet mes tyre. Në lidhje me programet e përbashkëta mund të zbatohen standarde të ndryshme nga ato të përcaktuara për programet e tjera. Menaxhimi i tyre bëhet nëpërmjet Komisioneve të përbashkëta midis universiteteve përkatës, të cilat ngrihen me vendim të Rektorëve. Këto Komisione shqyrtojnë, monitorojnë dhe drejtojnë ecurinë e procesit të zhvillimit të këtyre programeve në të gjithë elementët përbërës. Vendimet e marra nga Komisionet, lidhur modalitetet e zhvillimit të programeve të përbashkëta dhe përmbajtjen e tyre, kanë vlerën e vendimarrjes së organeve përkatëse në secilin universitet dhe janë të detyrueshme të zbatohen nga strukturat dhe personeli akademik të angazhuara nga universitetet partnere në realizimin e programeve të përbashkëta.

5. Kurrikulat e të gjitha programeve të studimit janë në përputhje të plotë me Sistemin Evropian të Transferimit të Kreditve universitare ECTS (CFU sipas sistemit italian), përcaktohen nga Njësitë bazë dhe miratohen nga Senati Akademik, pasi japin mendimin e tyre Rektori dhe Dekani përkatës.

6. Veprimtaritë mësimore, zakonisht, zhvillohen në selinë qendrore të UniKZKM-së dhe në degët e tij. Praktikantët mësimore të parashikuara në programet e studimit, në Shqipëri mbahen në laboratorët e Universitetit Katolik ZKM, në Spital, në Poliklinikë dhe në klinikat e Fondacionit ZKM, në institucionet shëndetësore publike dhe private, administratat, kompanitë publike dhe private, studiot profesionale dhe të tjera të ngjashme me to, sipas marrëveshjeve të posaçme. Në Itali, ato kryhen pranë Spitaleve e qendrave shëndetësore të Universiteteve me të cilat kryhen programe të përbashkëta studimi dhe në qendra të tjera shëndetësore dhe jo shëndetësore, ashtu si edhe pranë subjekteve të tjera publike apo private me të cilat janë dakordësuar marrëveshje. Mundësimi, koordinimi dhe lehtësimi i zhvillimit të tyre në Itali pranë institucioneve të ndryshme, bëhet edhe me mbështetjen e degës së Universitetit në Romë.

7. Strukturat e UniKZKM-së ofrojnë po ashtu programe studimi jo vetëm për përgatitjen e programeve të parashikuara në të, por edhe për formimin e vazhdueshëm, në trajtën e shkollave verore dhe të veprimtarive të ngjashme, të cilat shërbejnë për thellimin, plotësimin dhe konsolidimin e njohurive të mësuara, ose si mjete për rritjen e kualifikimit dhe të aftësisë profesionale të personave të regjistruar. Modalitetet e zhvillimit të këtyre programeve të studimit përcaktohen në mënyrë të detajuar në dispozitat e rregulloreve të brendshme.

Neni 48– Pranimet

1. Pranohen të ndjekin studimet e ciklit të parë dhe ato të integruara të ciklit të dytë në Universitetin Katolik ZKM:

- a) të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj që kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme ose titull ekuivalent të përshtatshëm për t'u pranuar në Universitet;



- b) studentët e transferuar nga Universitete të tjera që plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga Njësia bazë që ofron programin e studimit.

Të gjithë të regjistruarit duhet të respektojnë në çdo rast kriteret minimale të përcaktuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Lejohen të ndjekin studimet e ciklit të dytë:

- a) kandidatët që kanë përfunduar një program studimi në ciklin e parë të akredituar në momentin e diplomimit dhe plotësojnë kriteret e tjera, përfshirë ato të përmendura në paragrafin e mëparshëm;
- b) studentët e transferuar nga Universitete të tjera që plotësojnë të njëjtat kritere.

3. Lejohen të ndjekin studimet e ciklit të tretë:

- a) kandidatët që kanë përfunduar një program studimi në ciklin e dytë të akredituar në momentin e diplomimit dhe që plotësojnë kriteret e tjera të përcaktuara me ligj dhe ato të caktuara nga Njësia bazë që ofron programin e studimit;
- b) studentët e transferuar nga Universitete të tjera kombëtare ose të huaja që plotësojnë të njëjtat kritere.

4. Universiteti bën publike çdo vit kriteret dhe dokumentacionin që duhet të dorëzojnë të interesuarit për t'u pranuar në programet e ndryshme të studimit të UniKZKM-së, nëpërmjet shpalljeve përkatëse njoftuese për pranimet në UniKZKM. Rektori dhe Administratori i Universitetit, të ndihmuar nga drejtuesit akademikë dhe administratorët e Njësive të ndryshme, mbikqyrin respektimin e procedurave dhe të çdo formaliteti tjetër lidhur me pranimet e studentëve.

5. Për t'u pranuar në programet e studimit dhe në shërbimet e ofruara nga UniKZKM-ja, studenti duhet të bëjë rregullisht pagesën e tarifave të shkollimit dhe të kontributeve të tjera financiare të parashikuara në Rregulloren e posaçme.

6. Rektori, para fillimit të periudhës së duhur për paraqitjen e aplikimeve për pranim, mbikqyr publikimin e programeve të studimit të akredituara që ofrojnë fakultetet e UniKZKM-së, si dhe kriteret e nevojshme të kandidimit për regjistrim në ciklet e ndryshme të studimeve të ofruara nga Universiteti.

7. Në fillim të vitit akademik, Universiteti dërgon në institucionet/strukturat përkatëse të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin listën e plotë të studentëve të regjistruar me të gjitha të dhënat përkatëse.

Neni 49– Transferimet

1. UniKZKM-ja ofron mundësinë e transferimit të brendshëm të studentëve të tij dhe të atyre të ardhur nga Universitete të tjera, shqiptare apo të huaja. Transferimi duhet të bëhet në përputhje me kriteret dhe modalitetet e pranimet, të parashikuara për programin e studimit të zgjedhur. Afatet për dorëzimin e kërkesave të transferimit ndryshojnë sipas mënyrës së pranimet në programin e studimit të zgjedhur dhe afateve të përcaktuara eventualisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin.

2. Vlerësimi për njëhësimin e provimeve dhe njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student i transferuar, me qëllim vazhdimin e studimeve brenda UniKZKM-së, bëhet nga një Komision ad hoc i përbërë nga personel akademik i programit të studimit, të zgjedhur sipas kritereve të përcaktuara nga rregulloret e brendshme. Konkluzionet e punës vlerësuese të tij Komisioni ja përcjell Dekanit të Fakultetit. I takon Rektorit që, me propozim të Dekanit të



Fakultetit përkatës, të marrë vendimin përfundimtar për kërkesën e transferimit, si dhe për njësimin e provimeve dhe njohjen e krediteve.

3. Në rastin kur kërkesat për transferim në të njëjtin program studimie tejkalojnë mundësinë e pranimit neprogramin perkates te studimeve që zhvillohet në UniKZKM, do të pranohen studentët që kanë notën mesatare të ponderuar më të lartë.

4. Formalitetet e mëtejshme për procedurat e transferimit përcaktohen në dispozita të posaçme rregullatore.

Neni 50 – Provimet vjetore dhe ato të diplomës

1. Nota e provimeve vjetore shpehet me të tridhjetat. Nota minimale për marrjen e provimit është tetëmbëdhjetë / tridhjetë; nota maksimale është tridhjetë/tridhjetë me lavdërim.

2. Programet e studimit të cikleve të ndryshme parashikojnë si provim të përgjithshëm përfundimtar hartimin e një punimi të shkruar (e ashtuquajtura tezë e diplomës, e Masterit, e Specializimit ose e Doktoraturës) dhe mbrojtjen në publik të punimit.

3. Provimet lëndore dhe provimi i përgjithshëm përfundimtar janë të hapura ndaj publikut.

Neni 51 – Titujt e Studimit

1. Universiteti katolik ZKM jep diploma universitare të parashikuara nga ligji, si dhe diploma të përbashkëta universitare me universitetet italiane partneresi më poshtë:

- a) Diplomë *Bachelor (Laurea)*- me kohezgjatje 3 vite akademike dhe 180 ECTS/CFU
- b) Diplomë *Master i Shkencave (Laurea Magistrale)* - me kohezgjatje 2 vite akademike dhe 120 ECTS/CFU
- c) Diplomë *Master i Shkencave (Laurea Magistrale a Ciclo Unico)* – diplomë e integruar e ciklit të dytë me kohezgjatje 5 ose 6 vite akademike dhe 300 ose 360 ECTS/CFU;
- ç) Diplomë *Master Profesional (Master di Primo Livello)* - me kohëzgjatje 1 vit akademik dhe me 60 kredite ECTS/CFU;
- d) Diplomë *Master Ekzekutiv (Master di Secondo Livello)*- me kohëzgjatje 1 ose 2 vite akademike dhe me 60 ose 120 kredite ECTS/CFU;
- e) Diplomë *Specializimi (Specializzazione)* – me kohëzgjatje të paktën 2 vite akademike dhe me të paktën 120 kredite ECTS/CFU
- f) Diplomë *Doktoratë (Dottore di Ricerca)* me kohëzgjatje 3-5 vite akademike;

2. Gjithashtu mund të lëshojë certifikata specifike dhe vërtetime për shkolla verore, kurse shumë të specializuara, programe trajnimi ose kualifikimi dhe programe studimi të formimit të vazhduar.

Neni 52 –Diploma, Suplementi i Diplomës, Çertifikata ekuivalente

1. Në përfundim me sukses të çdo programi studimi, UniKZKM-ja, sipas dispozitave dhe procedurave të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për Arsimin, i lëshon çdo të diplomuari, në përputhje me llojin, nivelin dhe formimin që kërkohet nga dispozitat ligjore, statutore dhe rregullatore, *Diplomën* dhe *Çertifikatën e diplomimit* përkatëse. *Çertifikata* përmban, përveç rezultatit të diplomimit, rezultatet e fituar nga i diplomuari në çdo lëndë, kreditet e fituara si dhe informacione të tjera. Për çdo cikël studimi lëshohet edhe “*Suplementi i Diplomës*”, i cili, përveçse përmban elemente të kërkuara nga dispozita ligjore ose rregullatore si dhe të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për Arsimin, përmban edhe informacion mbi natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe



rezultatet e studimeve që janë kryer nga mbajtësi i Diplomës, si dhe fusha e punësimit. Informacione dhe formalitete të mëtejshme mund të vendosen nga dispozita rregullatore të brendshme ose të përcaktuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin.

2. UniKZKM-ja nuk mund të lëshojë një duplikatë diplome, por vetëm një dokument të barasvlershëm me diplomën, në formën e vërtetimit, që përmban emrin e Universitetit, numrin e diplomës origjinale, datën e lëshimit, ciklin dhe llojin e programit të studimit.

3 Në rastin e titujve të përbashkët ose të dyfishtë, kërkohet gjithashtu përputhshmëria me rregullat e sistemit ligjor kombëtar të partnerit të huaj dhe me normat e tjera të përcaktuara me marrëveshje. Titujt e përbashkët të studimit firmosen nga autoritetet përkatëse të universiteteve që realizojnë në partneritet programin e përbashkët të studimit.

Neni 53 – Dokumentacioni i Proçesit mësimor

1. Mbështetur në legjislacionin në fuqi, UniKZKM mban në formë të shkruar:

- a) *regjistrin themeltar të studentëve;*
- b) *regjistrin e arritjeve akademike;*
- c) *regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.*

2. *Regjistri themeltar i studentëve* është dokumenti që vërteton regjistrimin e studentëve pranë Universitetit KZKM. Regjistri plotësohet me shkrim dore si dhe në formë elektronike nga personeli i Sekretarisë Mësimore duke u bazuar në aktet nënligjore përkatëse dhe sipas formatit të parashikuar në to.

Mbështetur në regjistrin themeltar, çdo student pajiset me një numër unik matrikullimi, që e mban deri në përfundimin e programit të studimit dhe në marrjen e diplomës ose certifikatës, i cili pasqyrohet në këtë regjistër.

3. *Regjistri i arritjeve akademike* është dokumenti që vërteton rezultatet e arritura nga çdo student regjistruar në institucionin e arsimit të lartë, gjatë ndjekjes së programit të studimit. Regjistri ka elementë sigurie dhe plotësohet me shkrim dore si dhe në formë elektronike nga personeli i Sekretarisë Mësimore duke u bazuar në aktet nënligjore përkatëse dhe sipas formatit të parashikuar në to.

4. *Regjistri i lëshimit të Diplomave dhe Çertifikatave* është dokumenti që vërteton emetimin e tyre nga UniKZKM, të dhënat e regjistrimit të tyre dhe tërheqjen e tyre nga të diplomuarit. Ai plotësohet me shkrim dore si dhe në formë elektronike nga personeli i ngarkuar dhe përgjegjës për plotësimin, mbajtjen, ruajtjen dhe administrimin e tij, duke u bazuar në aktet nënligjore përkatëse dhe sipas formatit të parashikuar në to. Në fund të çdo viti regjistri skanerizohet dhe kopja elektronike e tij (PDF) ruhet në arkivin e universitetit.

Universiteti dokumenton tërheqjen e Diplomës, Çertifikatës së diplomimit dhe Supplementit të diplomës prej secilit të diplomuar që ka përfunduar me sukses detyrimet akademike dhe ato të tjera institucionale. Këto dokumenta tërhiqen personalisht nga i diplomuari.

5. Të tre regjistrat e mësipërm ruhen dhe arkivohen mbështetur në legjislacionin në fuqi për arkivat. Ata plotësohen me shkrim dore edhe në formë elektronike nga personeli i Sekretarisë Mësimore ngarkuar në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Regjistrat e mësipërm depozitohen në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet në arkivin e Universitetit për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së tij.



KREU I PESTË KËRKIMI SHKENCOR

Neni 54– Veprimtaritë e kërkimit shkencor

1. UniKZKM-ja garanton integrimin harmonik të veprimtarisë kërkimore - shkencore me atë mësimore. Personeli Akademik, studentët dhe Personeli tekniko – administrativ, të përfshirë në veprimtari shkencore, fitojnë njohuri të reja dhe zotësi të mëtejshme tekniko-shkencore në funksion, si të rritjes së tyre kulturore, profesionale dhe akademike, ashtu edhe, më tej, në të mirë të zhvillimit socio-ekonomik të Vendit, të përmirësimit të cilësisë së arsimit kombëtar, të zhvillimit të sistemit shëndetësor në planin e menaxhimit, në atë klinik dhe epidemiologjik.

2. UniKZKM-ja angazhohet që, edhe nëpërmjet rritjes së fondeve dhe të burimeve, të përkrahë sektorin e kërkimit shkencor si dhe të bëjë publike veprimtaritë e tij dhe rezultatet e arritura.

3. Në realizimin e veprimtarive kërkimore–shkencore specifike UniKZKM mund të bashkëpunojë me institucione publike dhe jo publike vendase e të huaja.

4. Një rol i rëndësishëm në këtë fushë i kushtohet përgatitjes, formimit dhe aftësisimit të studentëve në të tre ciklet, për të marrë pjesë dhe zhvilluar kërkim shkencor.

Neni 55– Dispozita të veçanta për financimin e kërkimit shkencor

1. Mbështetur në natyrën juridike të marrëdhënieve midis subjektit që zhvillon kërkimin dhe atij që e financon, Veprimtaritë e Kërkimit Shkencor grupohen në:

a. Kërkim shkencor i programuar institucional

Në Kërkimin Shkencor të programuar institucional përfshihen veprimtaritë kërkimore të realizuara me financime që Universiteti i vë në dispozicion të strukturave të tij.

Në përputhje me nenin 5 dhe me çdo dispozitë tjetër që lidhet me aspektet, qoftë dhe procedurale, të financimit të kërkimit shkencor, pjesëtarët e Personelit Akademik, të mbështetur edhe nga personeli tekniko-administrativ dhe studentët, kanë të drejtë të përdorin një pjesë të fondeve të miratuara në buxhetin e Universitetit për kërkime shkencore, sipas linjave programore të përcaktuara nga Departamenti dhe të miratuara nga Senati Akademik dhe nga Bordi i Administrimit.

b. Kërkim shkencor nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte dhe programe specifike të Kërkimit Shkencor.

c. Kërkim Shkencor për llogari të palëve të treta

UniKZKM-ja, nëpërmjet strukturave të veta dhe kompetencave tekniko-shkencore të pranishme në të, mund të kryejë kërkime shkencore, studime dhe konsulenza për llogari të palëve të treta ose t'i përfshijë ato në projekte të përbashkëta, në përputhje me rregullat e Statutit dhe me kriteret procedurale të specifikuar më mirë në dispozitat e veçanta rregullatore. Ky bashkëpunim rregullohet nëpërmjet marrëveshje *ad hoc* të nënshkruara.

d. Kërkim institucional nëpërmjet financimeve publike

Në këtë kategori përfshihet Kërkimi që zhvillohet nëpërmjet financimeve të dhëna nga institucione publike që promovojnë dhe mbështesin Kërkimin Shkencor.

2. Procedurat, kriteret dhe modalitetet e përdorimit të fondeve të Kërkimit Shkencor përcaktohen në Rregulloren e Kërkimit Shkencor dhe në akte të tjera rregullatore.

3. Të ardhurat eventuale, të gjeneruara nga veprimtaria kërkimore - shkencore, ndahen, midis strukturave të universitetit dhe subjekteve të përfshira në kërkimin shkencor, pasi nga buxheti i



përgjithshëm i Universitetit janë zbritur shpenzimet, në bazë të marrëveshjeve specifike të nënshkruara në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me vendimet e Bordit të Administrimit.

Neni 56– Botimet

1. UniKZKM-ja inkurajon komunikimin dhe shpërndarjen e produktit shkencor të Personelit të tij akademik, edhe nëpërmjet kontributeve për botimet.

2. Universiteti gjithashtu boton libra dhe periodikët e tij, edhe në format elektronik, në faqen e tij zyrtare të internetit.

KREU I GJASHTË DISPOZITA PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 57– Dispozita mbi buxhetin, kontabilitetin, shpërndarjen e aseteve dhe kontrollin e brendshëm financiar (auditimin)

1. Çdo njësi kryesore, deri më 15 korrik, i paraqet Administratorit të Universitetit parashikimet e tij për buxhetin e vitit të ardhshëm. Buxheti i përgjithshëm përgatitet nga vetë Administratori, në përputhje me parashikimet e buxhetit afatmesëm dhe të dhënat e marra nga strukturat e ndryshme universitare, të miratuara nga Senati Akademik dhe, më pas, nga Bordi i Administrimit.

2. Kriteret e menaxhimit dhe procedurat përkatëse administrative të kontabilitetit, si dhe format e kontrollit të brendshëm mbi efikasitetin dhe rezultatet e menaxhimit të përgjithshëm, përcaktohen me rregullore specifike të miratuara nga Bordi i Administrimit. ✓

3. Zërat aktivë të bilancit mund të përdoren në vitin e maturimit ose të transferohen në vitin e ardhshëm financiar. Asetet që rrjedhin nga kërkimi shkencor, shërbimet, konsulencat dhe veprimtaritë e tjera ndahen midis Fondacionit ZKM, Universitetit dhe Personelit Akademik të përfshirë në këto veprimtari, në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullatore të përcaktuara nga Bordi i Administrimit.

4. Pa cënuar autonominë dhe lirinë e kërkimit shkencor dhe të mësimdhënies, dhe pa cënuar kompetencat e Departamenteve dhe të Komisionit për vlerësimin e standardeve të cilësisë institucionale, UniKZKM-ja mund të përfshijë në strukturën e vet organizative një njësi auditimi (kontrolli) financiar të brendshëm. Emërimi i njësisë së auditimit të brendshëm financiar të Universitetit kryhet nga Bordi i Administrimit. Auditimi i jashtëm kryhet nga Fondacioni ZKM nëpërmjet audituesve të licencuarose nëpërmjet shoqërive të auditimit, të kontraktuar. Kontrollat financiare kryhen në bazë të programeve të hartuara nga Bordi i Administrimit ose nga Administratori i Universitetit, në përputhje me normat e sistemit universitar shqiptar, me rregulloret e brendshme dhe me legjislacionin shtetëror të fushës ekonomike/financiare dhe të kontrollit të brendshëm të subjekteve kolektive të së drejtës private. Dispozitat e mëtejshme përcaktohen në rregulloret e brendshme të hartuara nga Bordi i Administrimit.

Neni 58– Afati për shprehjen e mendimeve të brendshme

1. Pavarësisht afateve të ndryshme, të parashikuara edhe në rregullore, nëse opinioni i kërkuar nuk ofrohet brenda gjashtëdhjetë ditësh, Organi/Autoriteti përgjegjës për marrjen e vendimeve ose për lëshimin e urdhërave mund të vazhdojë pa marrë parasysh mendimin e kërkuar, ose mund ta përsërisë kërkesën, duke caktuar një afat të mëtejshëm.



Neni 59– Rregullore

1. Brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij Statuti, Rektori dhe Administratori i Universitetit, secili sipas kompetencave përkatëse, pas konsultimit me Senatin Akademik, i paraqesin për miratim Bordit të Administrimit Rregullorin e Përgjithshme të Universitetit dhe çdo rregullore dhe / ose akt tjetër të nevojshëm për menaxhimin e Universitetit, të strukturave dhe të veprimtarive të tij.

2. Deri në miratimin e rregulloreve të reja dhe të masave të tjera zbatuese, vazhdojnë të jenë në fuqi dispozitat rregullatore të brendshme aktuale.

Neni 60– Përfundimi i funksioneve dhe krijimi i organeve të reja

1. Procedurat për krijimin, përbërjen ose riorganizimin e organeve statutore fillojnë brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij Statuti.

2. Mbeten të pandryshuara afatet e funksioneve akademike dhe/ose institucionale deri në momentin kur ky Statut hyn në fuqi.

3. Bordi i Administrimit i Fondacionit ZKM vazhdon të kryejë funksionet e Bordit të Administrimit edhe për UniKZKM-në, deri në krijimin e tij.

Neni 61– Gjuha dhe interpretimi i Statutit

Ky Statut është i shkruar në gjuhën shqipe dhe në atë italiane. Në rast mospërputhjeje midis dy varianteve, duhet të bëhet interpretimi i bazuar në një kuptim të përputhshëm mes të dyja gjuhëve. Nëse kjo nuk është e mundur, do të mbizotërojë varianti në gjuhën shqipe.

